



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### IMBLEDHJES SË KATËRT TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.06.2020 (e Hënë), dhe ka vazhduar me datën 30.06.2020 (e Martë), Shkollën e Mesme Teknike Januz Zejnullahu në Viti”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emiri, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, Zyra Ligjore, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës. Me lejoni t’i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë situatë të pandemisë, shtabin emergjent, stafin mjekësor, drejtorët, këshilltarët komunal, Policinë e Kosovës, qytetarët e të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë situatë të pandemisë. Para se të kalojmë në pyetjet dhe përgjigjen, ju njoftoj, se na ka ardhur një shkresë nga Ministria e MAPL-së për shkak të situatës që jemi nuk do të behet shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve në në momenti që e marrim konfirmimin e ligjshmërisë do të ndërmarrim hapat e mëtutjeshëm.

Tani kalojmë tek pyetjet dhe përgjigjet. Fjala është për ju.

**z.Nuredin Lutfiu:** Përshëndetje të nderuar të pranishme! Kam një kërkesë nga banoret e fshatit Skifteraj, për ujin e pijes. Banoret pyesin për planin që ka qeverisja komunale, lidhur me ujësjellësin në fshatin Skifteraj. Ata theksojnë që zgjidhja më e mirë është rikyqja në ujësjellësin që vjen nga fshati Letnicë. Ju kujtojmë, se kjo kërkesë është urgjente për banorët e këtij lokaliteti. Dhe një pyetje për drejtorin e Inspeksionit, lidhur me një shenjë biznesi, e cila është të rruga e Pozharanit. Aty ka ankesa nga qytetarët, se ajo shenjë është pengesë për komunikacion. Dhe pyetjen e fundit e kam për drejtorin e Shërbimeve Publike, lidhur me mirëmbajtjen e ndriçimit publik në komunën tonë. E di që është një kompani e kontraktuar, por në fshatin Skifteraj, në disa lagje ka problem me ndriçim publik. Në disa poqe janë të djegura dhe disa lagje tjera kanë mbetur pa ndriçim publik. Nëse ke ndonjë përgjigje a ka këtë vit ndonjë investim në fshatin Skifteraj.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetje kam për nënkryetarin. Është bërë një marrëveshje e bashkëpunimit me UBT-në, për hartimin e planit zhvillimor komunal. E kisha lut nënkryetarin, që të na jep një

elaborim sa i përket nënshkrimit të kësaj marrëveshje, që është shumë domethënëse për Komunën e Vitisë. Pyetje tjetër kam për drejtorin e Shërbimeve Publike. Me paraqitjen e rasteve të reja, që janë në rritje, më intereson a është bërë deklorizimi dhe dezinfektimi në këto pjesë ku kemi raste të reja. Dhe pyetja tjetër, a ka fillu kositja e barojave anësore të rrugëve, sepse po paraqesin problem shumë për ata që janë në komunikacion.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Përshëndetje për të gathë të pranishëm! Shqetësimin e parë që do ta ngris është. Do të ishte mirë të ishte prezent edhe drejtoresha e Bujqësisë, sepse sa prezent. Siç e dini, muajin e kaluar ka pas një dëmtim në të mbjellurat e kulturës së shalqirit në fshatin Skifteraj, nga breshëri. Me sa e di unë, komuna e ka formu komisionin, ka dal në teren, ka verifiku sa është dëmi, sa janë dëmet e bëme dhe na duhet si raport. Po ashtu më intereson ta di, a keni bërë kërkesë në ministri përkatëse, për mi ribursu këta fermer, sepse dëmet janë shumë evidente, ka person që i ka të mbjellura 5 hektar dhe ka dështu totoleshit si kulturë bujqësore. Një shqetësim tjetër që e kisha ngrit është, se a ka punësime partiake në këtë rast, konkursin e fundit të shpallur nga shkolla fillore. Sipas asaj çka është publiku me 23.06.2020, është bërë shkelje drastike e të drejtave të njeriut. Zonja në fjalë ku e kam pa postimin e saj në rrjetet sociale, i është bërë padrejtësi e madhe. 100 pikë i ka marr në intervistën me shkrim, ndërsa kundër kandidatja e saj 98. Është shumë keq, që drejtori i Arsimit nuk është këtu me na dhënë përgjigje, duke e punësuar një bashkëfamiljare të nënkryetarit. Unë jam për mu respektu kriteret deri në fund, mirëpo zonja në fjalë i ka 10 vite përvojë pune, ndërsa zonja që është punësu ka diplomu në vitin 2017, me çka e kam të konfirmuar në rrjetet sociale, ajo i ka të gjitha trajnimet e kurrikulës edhe berthamë edhe kurrikules që i vyen për shkollë i ka më shumë se 10 trajnime të fushës profesionale. E vetmja e met e saj është, që nuk është pjesëtare e LDK-së. Prandaj unë mendoj që këtu është bërë shkelje e të drejtave të njeriut, sidomos ndaj kësaj zonje dhe ma marr mendja që arsyeja tjetër është, se për të kërkuar të drejtën e saj që ja lejojnë ligjet në fuqi. Kjo ju ka drejtu edhe gjykatës, po na po e dimë se si po shkon puna e gjykatave, prandaj që ka punësime partiake dhe shkelen të drejtat e njeriut, është me të vërtet shumë shqetësuese, sepse nuk mundet me ardh një person i cili ka 10 vite përvojë pune me dikan që nuk ka asnjë ditë përvojë pune. Kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive të ndryshme politike, po jo të diskriminohen të drejtat e tyre edhe kjo zonjë që tri vite bartet nëpër gjykata. Po thashtë Zoti që ta fitoj edhe lëndën dhe atëherë do të flas edhe me konkretisht. Këto janë të dhëna të publikuara në wëp të komunës, më 23.06.2020.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë i kame tri pyetje. Pyetja e parë ka të bëjë me një pjesë të kanalizimit në fshatit Smirë. Një lagje aty është e bllokume, është blloku kanalizimi dhe paraqet kogjo telashe dhe shqetësim për ata banor aty edhe ju lus të vini ta vizitoni dhe ta shifni gjendjen e të ndërmerrni diçka. Është viti i tretë që ajo lagje ballafaqohet me ta. Deri tash nuk ka pas disponim dhe vullnet nga ana e komunës, tash po ju ftoj të vini ta shikoni vet e ta vlerësoni si është gjendja. Pyetja e dytë ka të bëjë me furnizime me mjete higjienike të pastrimit, tek objektet shkollore, po posaçërisht e kam fjalën, sepse e kam vizitu vet se çfarë detergjenti ka aty. Kompania që e ka kontratën për furnizim të pajisjeve higjienike tek shkolla e Smirës, detergjentet dhe medikamentet që janë për pastrim, nuk e kane as një mbishkrim, nuk dijet as origjina e tyre. Dhe pyetjen e tretë e kam për pandeminë këtu në komunën tonë. Çka ka ndërmarr komuna dhe ku është situata? Edhe pyetje për kryetarin. Tash a ka kontakti me KFOR-in amerikan për këtë punën e pandemisë në Kosovë dhe a do të shpallet gjendja e jashtëzakonshme, dhe a ka garancion kryetari i komunës, se KFOR-i do të lëshon Kosovën? Se e ka pas dhënë një deklaratë të fuqishme me herët.

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë tu e pas parasysh që është koha që po rriten rastet e Covid 19, që është një gjendje më shqetësuese dhe po shifet me lirim e masave është ka rrezikohet një gjendje me e madhe e përgjithshme, kisha bërë një pyetje, se di kush na jep përgjigje, sepse drejtoresha është frik, rastet në Viti që po dalin: sa është rasti i tyre dhe me intereson që si po vlerësohen? Se po shof informata, që ka raste negative janë 6-7 raste gjatë ditës dhe asnjë prej tyre nuk i ka bërë testin. Qysh e di që testi është negativ, përderisa njerëzit nuk e kanë bërë testin, pa test janë deklaruar që janë negativ? A janë bazu vetëm në 14 ditë që është bërë, apo çka është në pyetje? Sepse i di rastet saktësisht që janë konstatu, që janë paraqit si shënime këto dhe nuk kanë bërë test që janë

negativ. Kjo me intereson. Në seancën e kaluar, tek gypi i ujës-jellësit, që është ende nuk është funksional, tha që bash sot janë tu bë do teste. Këtë e ke thanë në seancën e kalume, këto teste qyshe kanë dal, sepse na informatat që i kemi ato teste nuk kanë dal që janë plotësua kriteri që është kërku. Na për herë e kemi diskutu që edhe kur ka qenë tu kry puna që nuk janë tu bë në nivelin e duhur, sepse i kemi pas edhe informatat e tilla, na ke pas garantu nënkryetar, që në Prillin e viti të kaluar do të lëshohet, nuk është lëshu në Prillin e viti të kaluar, edhe prilli i këtij viti nuk është lëshu dhe ai nuk i plotëson asnjë kriter hiq, bazë informatave që i kemi ne nga njerëzit që merren me at lëmi. Më intereson një informatë nënkryetar. Edhe isha kyq tek qasja në dokumente zyrtare. Ka mbi tre muaj që kemi bë kërkesë për disa dokumente zyrtare, Zyra e Informimi naj ka kthi informatën, që nuk janë tu naj sjell ata që janë përgjegjës. Na atë kërkesë ja kemi dërgu edhe Zyrës së Prokurimit edhe zyrës së drejtorit. Asnjëri nuk po naj sjell ato dokumente që i kemi kërku. Na konstatojmë që ato ke përdorime që i kemi paraqit ne për atë projekt, që kemi kërku edhe informata, ato qëndrojnë, sepse kur edhe informatat meshifen edhe punët nuk janë kryer krahas projektit, na konsiderojmë që ato keqpërdorime duhet me i meshef diqysh. Përderisa nuk keni mujt me i përmirësu me letra, me i meshef, çashtja në teren dhe kontratat tregojnë, që aty keni keqpërdorë mjaft shumë. Nuk janë kry ato punë që i keni publiku. Na keni dhënë vërejtje, pse na kanë herë po i publikojmë ato që nuk qëndrojnë, mirëpo përderisa asnjë letër nuk e bëni për at që kërkohet, që e parasheh ligji. Këtë kërkesë, d.m.th ju jeni keqpërdorues të atyre projekteve, sepse ato po i mshefni edhe përmes ligji, që e keni obligim me i sjell ju.

**z.Taulant Haxhiu:** Përsëritet të nderuar të pranishëm! Unë fillimisht ju uroj këtë koalicionin e shpresës ndërmjet LDK-se dhe AAK-së, vetëm kryetarit z.Sokol Haliti dhe z.Faruk Nura besoj që me këtë koalicion do të ketë një progres Vitia, koalicion qesharak. Unë edhe njëherë për drejtorin Ramiqi, e 15-ta herë që unë kërkoj një llogari për këtë urën që po e qua Ura e Sonë Franciskos, e cila ka kushtua 219 mije euro, janë dhanë në këtë urë që e kemi këtu përball. Asnjëherë nuk me ki pru të dhënat që me ki kërkuar. Nëse edhe në seancën tjetër nuk m'i sjellni këto, beso që ka me thirr një ekspert privat me e verifiku. Këtu ka pas një keqpërdorim. Nëse nuk ka pas keqpërdorim këtu, atëherë sjellni faktet dhe argumentone. Kam kërkuar përsëri për renovimin tek shtëpia e kulturës, kuvendit komunal, Zyrës së Kryetarit, komunës se vjetër. Këto renovime që janë bë, kam kërkuar prej teje që të ma sjellësh komplet kush ka qenë përfitues dhe sa kanë kushtu këto renovime. Asnjëherë nuk ma ke sjell këtë informatë. Unë ka mi shku deri në fund kësaj pune. Të lutem të jesh me i saktë, është e 10-ta herë që po kërkoj këto.

**z.Rasim Terziqi:** Përsëritet të nderuar të pranishëm! I uroj koalicionit LDK-AAK suksese. Na kanë pas quajt qyqar një kohe mu e Sametin, që ja kemi pas dhënë votën. Po, qe erdh puna e lëshun bajrakun edhe këta. Po, e vërtet që mu më kanë rrejt, për qat se kam gjet vendin e punës edhe unë jam qytetar i Kosovës që i paguaj kontributet. Unë jam biri i shtat i babës, kurrë privilegje prej asnjë pushteti nuk kemi fitu, e dikush ka pas edhe në kohën e komunizmit, edhe në kohën e tilla, a unë kurrë. Me familje jemi kanë të shkeltë, unë jam me fakultet, bashkëshortja dhe tre nipa me fakultet, tri mesa me fakultet, kurrë privilegje prej pushteti nuk kemi pas. E tash, qohet dikush thotë, që nuk ta kanë gjet vendin e punës. E vërtet është kjo që nuk ma kanë gjet vendin e punës. Unë e di qysh është bë diskriminimi tek familja jem. Tek ndriçimi në Zhiti, qysh është bë diskriminimi i njerëzve që nuk janë pjesë e LDK-së është një familje që sa pjesë e LDK-së, është anëtar i PDK-së, e kemi lënë të diskriminime, vetëm ajo lagje 4-5 shpi që nuk i keni bë ndriçimi asaj lagje, është e keqe për qytetarët kjo me bë, kësi diskriminime. Madje kam pas kërku prej kryetarit tek ura e Halabakut, që është bë ajo që janë hek barnishtat, është mush me dhe aty, u në mirë vetëm që ato ujërat e zeza. Aty që mbarojnë u kanë mirë mi shti në gypa, sepse po kundërmon ka interes, p.sh.: me dal qytetarët me nejt në at park, mirëpo nuk po muj, sepse po kundërmon erëra të këqija, ka mujt p.sh.: qato pare për rregullimi e asaj pjesë që ujërat e zeza që kaloj aty me i shti përmes qypave që mos të kundërmojnë, dhe pyetja e tret është ndriçimi i krejt lagjeve, është në Pozharan vetëm rruga Terziu, Korrani, Bugujevci atje nuk ka ndriçim. Kam kërkesë nga këta qytetar, që me bë ndriçim në at lagje.

**z.Ekrem Pira:** Përsëritetja për të pranishmit! Ata çka dashta me thanë unë, një pjesë e tha Bekimi, për çështjen e ujit. Para një muaji nënkryetari tha, besoj që brenda dy jave do të finalizohet çështja e ujit dhe uji për pije në Viti

do të vjen me gypat e ri. Tash po pyes, a ka naj afat tjetër, sepse u bë një muaj nuk u bë ajo punë. A ka ndonjë afat tjetër që qytetaret po me pyesin për çdo ditë, se kur do të behet kjo. Pyetja tjetër, e di që janë bë shume punë edhe nëpër fshatra, po p.sh.: në qytet tek rruga “Sherif Frangu” ose tek pumpa e Alidemve, sot besoni që nuk ka kanalizim. Këtë e kam përsëri më se paku që 7-8 vite. Po ju tregoj që tashti është kohë e nxehtë, njerëzit nuk po mujn me bajt, sepse ujërat e zeza janë mbi tokë dhe e zajn rrugën qytetaret, nuk kanë me mujt me e bajt, që ujërat e zeza me ju hi në oborre, ka me pas ndoshta edhe konflikte e me pas konflikte mas 20 pas luftës për një kanalizim 500 metra, apo sa i ka. Është përgjegjësi për udhëheqësit e komunës, se për juve nuk është përgjegjës vetëm ku ju bjen, mirëpo edhe ku ju bëjnë keq, po e përsëris mundet me pas konflikte në atë lagje prej njerëzve, sepse nuk po muj me bajt më ato ujëra të zeza, me ju shku tek shpija.

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! E kam një kërkesë për drejtorin për Rini dhe Kulturë. Drejtor, me intereson ta di tashti, më kanë kaluar një vit kur këshilli i fshatit Drobesh, bashkë me organizatën e veteranëve dhe dëshmorëve, e ka dorëzuar në Zyrën e Kryetarit një kërkesë, që stadiumi në fshatin Drobesh, i cili është duke u ndërtuar, të emërtohen me emrin e dëshmori Muhamet Muharremi. Ende nuk ka asnjë përgjigje, as nga ju as nga Zyra e Kryetarit, pra kur do ta marrin familjarët përgjigjen. Nënkryetar, tregu i kafshëve në fshatin Drobesh, lokacionin e keni të caktuar, janë ndërtuar rrethoja në atë, kur do të bartet prej vendit që është tani në vendin e ri, sepse e dimi që tregu i kafshëve momentalisht është në rrugën magjistrale Viti-Gerlicë dhe banorët janë të rrezikuar, po njëkohësisht unë kam vizitu edhe tregun e gjelbër të Viti, dhe realisht tregtarët nuk kanë qenë të kënaqur me gjendjen momentale të tregut ne Viti dhe sinqerisht nga ana e tyre, tregu i gjelbër i Vitisë cilësohet si tregu me i keq në Anamoravë. Nuk ka ujë, nuk ka tualet, nuk është i shytuar më asfalt, gjë që nuk ka kushte që të ju mundësojnë që të kryen punën tregtarët. A keni mëndu ndonjë zgjidhje për këta tregtar.

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Është çështja rreth pyetjeve që kam bë deri tashti në këtë kuvend. Dy prej tyre po i veçoj e të tjerat po mundohem t’i përfshi me një. E para, në një seancë të kuvendit kam ngrit problemin e ndërtimit të një parkingu për vetura tek shkolla e Mesme “Kuvendi i Lezhës”, dhe që nga këtu është premu që ajo shumë shpejt do të realizohet, po megjithatë drita në fund të tunelit nuk po shifet. Po bëj pyetje deri ku ka mrri kjo çështje. Po ashtu rreth furnizimit me ujë të pijshëm të fshatit Remnik. Kam ngritur disa herë edhe për këto bëjë pyetje, se deri ku ka mrri kjo procedurë dhe çka është në plan. Megjithatë, po ju njoftoj, se ka iniciativë nga qytetarët e fshatit Remnik, që të bëjnë një petition dhe t’i drejtohen komunës rreth kësaj problematike. Sa janë realizu apo konkretizu çështjet ose pyetjet që janë bë rreth shume çështjeve, siç është kanalizimi e shume të tjera, mos t’i përmend sa janë realizuar deri tash dhe a janë marr parasysht ato që janë marr nga ana ime ose a janë të shënuara dikun fare, apo janë të shënuara dhe të vendosura e të ruajtura dikun në sirtar sa për tu arsyetuar tutje, se ne kemi diskutuar edhe këto probleme, po nuk kemi arrit t’i sqarojmë. Pyetja është: vall, mos i keni akseptuar këto adresime të mija si probleme të LVV-së dhe duke harruar se të gjitha këto kanë qenë çështje për qytetarët dhe të ngritura nga qytetarët përmes meje si përfaqësues i tyre.

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Edhe unë do ti ngris disa çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me qytetarin e komunës sonë. Sa i përket çështjes së ujit, u ngrit nga parafolësit. Unë do ta ngris një problem që ka të bej me zonën industriale në drejtim të Klllokotit, aty operojnë dikun mbi 20 biznese. Me që muj me thanë, pjesa dërmuese operon. Në atë pjesë ka biznese që po thuj kanë edhe mbi 100 punëtor, siç e kemi rastin e “Mediterranit”. Paramendoni në atë zonë nuk janë kushtet elementare, tu fillu nga trotuari, kanalizimi, ujësjellësi, ndriçimi. A mendoni që krejt ato punët duhet me shku me makina të tyre në atë pjesë, deri tek vendi i punës në atë pjesë. Po sikur të ishin këto kushte elementare, ata punëtorë nuk kanë nevojë me shku me makina me bë shpenzime, me e ngarku komunikacioni. Unë jam i sigurt që nga pjesa e stacionit do të udhëtoni në kam deri tek vendi i punës. Po mendoj që është e domosdoshme që me ja ofru këto kushte elementare, sepse fundi i fundit jemi në shërbim të tyre. Ne e kemi fol bukur shumë për Zonën Ekonomike atje poshtë, këtyre bizneseve që i kemi këtu, nuk ju kemi ofru kushte elementare. Paramendone, kjo është fakt, kështu që kërkoj që ky problem të merret me seriozitetin më

të madh dhe të ju ofrohen këto mundësi këtyre bizneseve. Tjetra, ka të bej me Zyrën e Katastrit. Kam qenë një ditë për punë të mija personale. Aty i ki dikun 8 punëtor që punojnë kokë mbi kokë. Paramendoni edhe pa pandemi ata nuk mundën me punu, nëse ndonjëri kërkon pak privatësi. Kërkoj që atyre të ju ndahen zyrat, a me xham apo me çka ta shihni të arsyeshme, mirepo të krijohet privatësia pak edhe për punëtor po edhe për palët. Me çështjen e ujit në fshatin Goshicë, komuna ka kërku, që qytetarët të kyqen në gypin e ujësjetllësit, mirëpo në këtë gjendje qysh është, është e pamundshëm me u kyq, sepse qypi është vetëm me një rën anë të fshatit, është i ndarë në dy pjesë. 50 shtëpi në një rën anë, 50 në anën tjetër. Si do të kyqen ata që janë në anën e kundër me gypin. Tash asfalti a do të prehet në 50 vende, nuk ka mundësi, duhet me ju ofru kushte për mu kyç.

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë do të mundohem të ju përgjigjem pyetjeve të parashtruara nga ju. Po fillojmë me kërkesën për ujin e pijes, një kërkesë shumë herë e përsëritur. Vlen të njëjtat fjali, përderisa e kemi atë gjendje në Letnicë, mos rritja e kapaciteteve që mund me pas ujë të mjaftueshëm edhe për vitias, Skifteraj. Unë konsideroj që vetëm është me bë fjali me shumë, e zgjidhje jo, ne e kemi pas frik një takim së bashku kryetarin, me përfaqësues e “Hidro Moravës” të organizimit regjional dhe të CDI-së dhe e di që Skifteraj është në grupin e shtat fshatrave mu rregullu çështja e ujësjetllësit dhe njëherë e përgjithmonë me fillu e mbara, shenjën me siguri do ta rregullojmë, edhe pse me siguri u vendos në aspektin profesional. Po nëse i pengon qytetarët, ajo çështje do të zgjidhet. Problemi për ndriçim publik. Drejtori i shërbimeve publike si problem e shqyrton dhe mundet me e evidentu. Marrëveshja me UBT-në. Ju e dini se sipas ligjit tash e kemi obligim ligjor hartimin e planit zhvillimor komunal dhe në bazë të hulumtimeve të cilat i kemi bë, ka dal se me UBT-në do ta kemi një kosto më të lirë. Kanë shpreh edhe ata gatishmërinë, tu e pas parasysh që edhe ana profesionale, numrin e madh të profesorëve që e kanë dhe kemi bë ligje që është edhe e lejueshme një marrëveshje të cilët do ta bëjnë hartimin e planit, gjithherë tu bashkëpunu edhe me profesionistët tonë që e kemi në kuadër të drejtorisë. Për koshtjen e barojave, e kemi drejtorin këtu, ju përgjigjet, dëmet që janë shkatërr në kulturat bujqësore në Skifteraj, edhe pse jemi në rrethana shume të lënduara për shkak të pandemisë, ne me kohe e kemi bë edhe formimin e komisionit për të cilën e di që shumë herë kemi trokit edhe në Ministrinë e Bujqësisë, që të kemi një komision miks. Ka ardh edhe një anëtar nga ministria, kanë dal në vendin e ngjarjes, i kane konstatu dëmet të cilët janë bë, ka bë edhe një raport po me më dal se numrin shifrën nuk e di, po e di që ai raport u dërgu edhe në ministri, ndërsa ju e dini si këshilltare e kuvendit komunal, fond për mi pagu ato dëme i ka vetëm ministria dhe jo komuna. Çështja të cilën e ngrite rreth konkurseve, janë instancat të cilët duhet të ju drejtohen, në rast se ka asi padrejtësi, dhe ka, atëherë me siguri do të vendosin instanca të tjera dhe gjykata, megjithatë duhet ta kuptojmë që edhe ne kemi familje që edhe ata duhet me punu, prandaj janë të nivelit qaq të dobët, qaq të ulët, që një këshilltare e kuvendit komunal mendon dhe etiketon, po megjithatë ne do të vazhdojmë të hecim. Në rast se aty është shkel konkursi, ai duhet me ndjek atë pune deri në fund. Kanalizimi në Smirë. Ne e kemi pas një kompani me siguri drejtori do të jet me adekuat, se kemi marr me probleme një çështje e kemi vazhdu edhe ne e dimë problemet e Smirës, megjithatë e kemi këtë gjendje, jam për me bë përpjekje maksimale që me u bë zgjidhja. Ato që u tha, e ftoj kryetarin me shpall gjendje të jashtëzakonshme, ajo është politike, po megjithatë edhe ju jeni më bë politik, sepse dihet kush e shpall gjendje dhe nuk jemi ne që merremi me atë. Sipas informacioneve, mos mi merr zyrtare, po megjithatë tash e di se qashtu kam informata, se paska 14 dite ata që nuk kanë simptome, po konsiderojkan negativ. Plotësisht pajtoj aty, që thave ti, a ju kanë bë teste të gjithëve. U tha që ujësjetllësi nuk i plotëson kriteret dhe me tha që kam thanë brenda dy jave. Nuk e besoj që e kam thanë brenda dy jave, kam thanë që janë tu punu, kanë qenë të njëjtën ditë, nuk kam raport me shkrim. Me pas ditë që e bëni këtë pyetje, kisha kërku raport me shkrim. Megjithatë me kanë than që atë ditë nga pompat të cilat unë muj me gabu në aspektin profesional, ndërsa në aspektin e informacionit asnjë presje nuk e gaboj. Ata paskan qenë atë ditë, e kanë testu pompën, ata bart të cilën duhet me ja ngrit nuk e kane mrrri at shkalën të cilën duhet me e mrrri dhe pikërisht për këtë ja kanë ndërpre punën dhe i kane thanë, përgatite me pompa më shumë dhe kur të mrrrihet ajo shkollshmeria e bar pikërisht per këtë ja

kane ndërpre punën dhe i kane than përgatitu me pompa me shume dhe shkallëshmëria e atyre bar kur të mrihet, për ndryshe nuk e pranojmë. Tash a ka parregullsi gjatë kanalit, nuk muj me hi për shkak se duhet me than profesionistet këtë. Ne duhet të thirrmi në at çka e thojnë profesionistët, kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, është e drejtë ligjore, megjithatë, nëse ke pas një refuzim të tillë mundesh me ju drejtu instancave të tjera, po besoj që ne kemi pas mirëkuptim deri tash, e nëse ka ndonjë drejtori te koka prezent dhe përgjigjet. Koalicion qesharak. Ju qysh dush ta quani, ne a e dinë ku dallojmë mes juve, se mu çfarë koalicioni bën ti, nuk me bën përshtypje, se ti e zgjedh formën më të mirë të mundshme. Në politik është qashtu, ne e kemi parapa këtë koalicion, a del mirë a del keq, tash përgjegjësinë e bartim ne dhe ata. U tha e keni lan pa ndriçim një shpi në Zhiti. Nja po ta thamë, me përgjegjësi të plotë, janë nja tri katër lokalitete që 7 vite, jo që jam në qeverisje unë, po duhet me qenë shumë falënderues për pushtetin. Në mesin e tyre është edhe Zhitia, asnjë rrugë nuk e ka pas të asfaltume, as asfaltin kryesor, po krejt i ka bë ky pushtet dhe pasmi ardh me një dritë të koka puna keq. Ujërat e zeza, është mirë me i këshyrë, atë çështje me e eliminu. Çështja e ndriçimit, ndoshta është mirë më bë një analizë, sepse edhe kosto është rrit bukur shumë, po megjithatë nëse është frekuentim i madh i njerëzve, duhet të shikojmë edhe atë, ndoshta edhe është në projekt tani. U kërku afat për ujë, besoj që afati për ujë vlen, se në afat sun lidhmi, për shkak se duhet ta kemi të kjart, ne si komune kemi investu edhe ju e dini vetëm në hapin e kanalit, ndërsa çështjet tjera ka investu CDI-ja, andaj nuk varet krejt prej komunës. Me pas qenë prej neve, e kishim kry, jo vetëm rruga “Sherif Frangu”, kemi shumë, po besoj që në rrugë dhe lagje, sepse frik i kam pas edhe një delegacion këtu tek “Dëshmoret e Vitisë”, edhe aty janë disa shtëpi që nuk e kanë kanalizimin, nuk duhet të politizojmë, po megjithatë nëse vjen dhe bisedojmë në zyre, të tregoj se cili del fajtor për me ndërdua një shtëpi në qytet, në radhë të parë duhet mu pajis me krejt dokumentacionet për kyqje në kanalizimi, ujësjellës. Po Vitisë i ka ndodhë një prurje e madhe e njerëzve të cilët pas luftës nuk pyeten për kanalizim e për ujësjellës dhe kësaj çështje ne i kemi shku mbrapa. Tani, sepse ata kur kanë ndertu aty e kane dit që nuk kane kanalizim. Me pas mundësi asnjë shpi nuk e la pa kanalizim e ujësjellës. Çështjen e stadiumit, te emërtimi. Edhe në atë kohe është drejtu kërkesa gabimisht. Pse është komisioni për emërtimin e rrugëve dhe shesheve. Nuk është as kryetari i komunës kompetent për at çështje, as drejtorja, duhet ta gjeni adresën e saktë për me drejtu kërkesën. Tregun e kafshëve. Besoj që në seancën e radhës do të përgatitet, po bëjmë përpjekje që të ja japim në menaxhim njerëzve profesional, me qit me ankand publik, të cilët do të sigurojnë edhe ujë edhe çështjen profesionale të menaxhimit të atij tregu, jo sikur që e kemi pas deri më tani. U cek për tregun e gjelbër. Nuk e di a keni informacion, për fat të keq nuk është në prone të komunës, është në prone të AKP-së, ashtu siç është ajo pjesa që ne jemi ballafaqu pa ndërpre me shume probleme. Me siguri që nja 7 vite e di që nja 10 here ju kemi drejtu qeverive përkatëse. Kërkojmë për me naj liru shumë prona të cilët janë ndoshta bazë për orientimin e zhvillimit të Komunës të Vitisë, të cilat janë konsideru që janë pengës deri me tani. Parkingu tek shkollat e mesme ishte një pyetje. Nuk kam përgjigje për këtë. E di që duhet të behet zgjidhja, për këtë po nuk kam përgjigjeje tani per tani, furnizimi me uj të pijes në lokalitet edhe kjo eshte e përfshime në at marrëveshjen e CDI-së ende konkrete nuk kemi diçka në takimin e fundit kemi bisedu edhe me çështjen të unë e mbroj at konceptin ndoshta e kame gabim individualisht gjetjen e një burimi i cili do të ishte me ramje të lirë tash kur do të behet ajo shpurja ithtar i ujësjellësit ne fshatin Remnik. Gjithëherë jam ithtar i asaj që të jet me ramije të lirë për shkak se këto që po behet me sistemi e pompamave, ka kosto buxhetore edhe të mirëmbajtjes ndoshta tu e pas parasysh që edhe unë vij nga ai lokalitet, ndoshta edhe nuk po guxoj me than po nga pozita gjeografike ndoshta edhe uji do të jet i kualitetit me të lartë. Shumë kërkesa të cilat kanë ardh, të jesh i bindur që të gjitha janë të regjistruara, është e vërtet se ti e ki paraqit si qytetar, po gjithherë duhet me pas parasysh se regjistrohesh si këshilltar i subjektit nga vjen. Përveç që i ki të regjistruara kërkesat, i ki edhe në proces. Unë i kam përsërit shume herë, duhet ta kemi të kjart, kërkesat e qytetarëve vetëm ato që janë të domosdoshme, për shkak të situatës së krijuar duhet të merren, sepse çdo kryetar i komunës e qet atë programin e vet që i ka fitu zgjedhjet dhe ai i përmbahet ato, mund ndonjë të ndodhe për shkak të situatës që është emergjente, po megjithatë obligativ dhe sipas ligjit edhe sipas matësve të cilët

e masin punën e tij shume organizata joqeveritare dhe ato qeveritare është programi të cilin ai e ka elaboru gjate fushatës zgjedhore dhe ai po bën përpjekje maksimale ti përmbahet kësaj. E di që edhe në zonën industriale i kane ato shqetësimet të cilat i paraqiti ti e din shume herë e kemi bisedu një çështje po këto qeveritë e tona po ndërrohen si shpesh, dhe shume herë e kane premtu atë e kemi pas edhe në program dhe e kemi than, që do të jet një tretuar që do ti shërbej atyre që operojnë aty, megjithatë nuk kemi arrit me realizu. Besoj që në të ardhmen e afërt do të realizohet. Tek çështja e punëtorëve të cilët mos respektim të distancës sociale apo krijimit të kushteve. Unë besoj që atje ka hapësirë të mjaftuara, po megjithatë mund të ndodh, do të bisedoj me drejtoreshën që është në pushim dhe ta shofim çështjen e organizimit sa më të mirë. Tek kyqja në ujësjellës. Edhe nga ana tjetër me qit gypin. Kjo ana tjetër duhet me gjet një formë, një mënyrë ndoshta nëse eksiton e shpumpjes. Sa kushtojnë ato nuk e di, po ka asi që e shpojnë dhe kyqen pa e kput asfaltin, se na Remniku jemi të kyqit po ujë nuk kemi.

**z.Ekrem Azazi:** Përgjigja ka qenë diplomatike e juaja nënkryetar. Në këtë kuvend, në këtë mandat keni than që CDI-ja i ka kry punët e veta edhe komuna i ka kry obligimet e veta, cilat janë pengesat tash që mos mu bë kyqja por e CDI-së. Sa i përket lagjes, ajo lagje unë po thamë që nuk ka kanalizim, ajo lagje u kane e banume edhe para luftës, disa shtëpi janë maru menjëherë pas luftës, ka lagje që para tri katër vite që kane fillu mu ndërto shtëpiat në ato lagje, nuk ka dallim ajo lagje me këtë lagje. Ajo lagje po e përsëris aty kane jetu njerëzit edhe para luftës, po menjëherë pas luftës janë ndërto shumica e shpiave, d.m.th kjo kërkesë ka qenë kur ka qenë edhe kryetari i PDK-së në pushtet. Ai kanalizim nuk është bërë, e kryetari ju ka thanë qytetarëve që kjo pune ka mu kry shume frik e kjo pune nuk u kry po get që aty nuk ka njeri që është i fort si lagje se me pas qenë një lagje tjetër, ajo pune ish kry. Këtë po e thamë me vetëdije të plotë, vetëm po e përsëris nëse ndodh naj pune e keqe në mes të atyre njerëzve në lagje, përgjegjësinë do ta keni ju po e përsëris për se dyti herë. Po qysh jam tu e pa unë, ka me pas përlëshje ndërmjet atyre njerëzve. Bisedone me lagje, shifne edhe vet.

**znj. Mirlinda Sadiku:** Nënkryetari nuk priton kur është puna për klasifikime të ndryshme me thotë që është e ulët nuk banë nder mos e ki gajle për reputacionin tim. Unë e kam ndërtuar nder vite, hiq mos e ki gajle, largone ato që e ki mes personin në fjalë në aspektin profesional, po flas si mësimdhënës që 16 vite personi i cili ka konkuru i ka marr 100 pikë në test me shkrim, d.m.th 100% për 100% e ka mbush testin. Dallavera ju ka bërë në intervistën me gojë, zonja në fjalë i ka 10 vite provoj pune, ndërsa kundërkandidatja 2017 ka diplomë i ka mbi 10 trajnime të lëmisë profesionale për mësimdhënie në ciklin e ulët që jo çdo kush mundet me i kry, prandaj me thuaj në aspektin profesional cila ka pas të drejtë, ju mund të arsyetoni te komisioni që e keni formu që ja ngrëni dizginat ka të doni, sepse kjo u bërë, u ditë moti se kush ka me ardh para 3 muajve e kame dit se kush vjen edhe kundër kandidatën e kane ditë informacionet. Mirëpo sa për informacion, kjo e ka fitua lëndën edhe në gjykatë, prandaj me plot të drejtë edhe mu më bënë nder dhe nihem shume krenare që jam zë i asaj grua këtu në kuvend, me i sipërfaqe dhe me i shpalos padrejtësinë që i bëni ju gjate punësimeve partiake edhe ky nuk është punësimi i pare i anëtarit të juaj të familjes.

**z.Bekim Azizi:** Kur ta ngojma ne nënkryetarin, ta merr mendja që ky është i gjithëdijshëm, mirëpo e ka një mundësi që me bërë mos me e njoft perime ta mush mendjen që është qashtu, po ne kur po i dimë proceset dhe kur po i dimë punët që naj përsërit çdo seancë edhe për shkak të respektit na nuk po merrem fort me ta. Kanjëherë po e merr përgjegjësinë edhe të drejtorave. Tha që Zhitia duhet me ja ditë për nder se kurr kerkushe nuk ka bërë kurgja a e ke bërë kanalizimin ti në Zhiti, ujësjellësin si që e ki në Remnik e ka bërë dikushe para teje ju vetëm asfalte keni shtru sepse me asfalte e keni knaq sepse keni keq përdor as një asfalt nuk e keni shtru sa u kane e parapamë as një e di që ti nuk e ki bërë sepse nuk je kanë në mbikëqyrje mire po kanjeher po mundohesh me i mbulu krejt, në seancën e fundi ka koisendu që ke than sot janë tu e bërë edhe matje ne gypit mire po mu me preku që thave mundemi me dal me pi kafe dhe me të dhënë informata jo ti je institucion ti duhesh me i pru raportin e tyre qajo është zyrtare, eksperti duhet me bërë nje raport a i plotëson presioni e shtypjes në bar jo me pi kafe na jemi persona zyrtar këtu dhe kërkoj raport zyrtar edhe le të dijet që qai që e qet nënshkrimi le të është përgjegjës për qata.

**z.Ali Bajrami:** Shume shkurt dhe shume i kuart konkursi ka qen publik ka të drejt çdo qytetar i Republikës së Kosovës dhe jashtë Komunës së Vitisë të konkurroj ka qen komisioni vlerësues i cili e ka vlerësu edhe sipas procedurave duke u bazuar në ligj është pranë kush është pranë ata anëtar të atë komisioni kanë një kribilitet intelektual dhe familjar janë koleg tutë që janë të Drejtorisë së Arsimit, prandaj me bë kësi fyerje i keni vnu frenat dizginat qaq denigruese qaq e ulët është që unë po turpërohem kur po e dëgjoj këtë fjalor prej profesoreshës që naj edukon gjeneratat e reja.

**z.Taulant Haxhiu:** I nderuari nënkryetar, kur po del me fol këtu ne foltore po me dokesh si plakë i katunit. Po dëgjo koalicioni qesharak a e din pse thash, se një koalicion që bëhet pa përkrahje të një anëtarësie bëhet në mes të një kryetari i cili diktaktor dhe ishe një revali të tij pa pëlqemini e kryesisë at her quhet koalicion qesharak.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Mas keqi është më fol për diçka që nuk e din. Që 16 vite me ligje të arsimit jam tu ballafaqu, se pikërisht partia jote me ata super të dëgjueshmit, e kame than njëherë po e përsëris prapë me 28 shtator me ka ardhe në ore për arsye politike para dy vite, për çështje që kame ngrit në kuvend, është mbajt dëgjim publik prej personave të caktuar. Unë nuk ndihem e thyme zotri Ali Bajrami aspak, unë jam shumë krenare që flas në emër të asaj grue. A e din pse sepse ashtu e kërkojnë ligjet e Kosovës, Ligji i Kosovës për Arsimin Parauniversitar kur të punësohen punëtorët shume kuart e thotë, është kualifikimi, e dyta është provoja, e treta është trajnimet që ti nuk i din këto edhe e fundit ti e fyve edhe Gjykatën Themelore në Viti, ku zonja e ka fitu gjyqin, prandaj apo sheh që nuk i di senet. unë fola në bazë të argumenteve e nuk fola vetëm që po du me than diçka.

**z.Ali Bajrami:** Çka di e çka nuk di unë, nuk je ti me me vlerësu mu. Një detal që e përmende ti, që se pasna ditë unë, thave që edhe unë i kame marr orët politikisht. Shume gabim ki bë.

**z.Hasan Aliu Nënkyetari i komunës:** Bekimi me tha po të respektojme shumë. Jo unë po i thamë Bekimit, rrespektom vetëm sa jam, hiq më shumë. Unë ta thash me sinqeritet, se unë në raport me ty e me të gjithë ka qen ju kame respektu ndoshta shume më shume se ju që me keni respektu dhe në atë kontest unë ta thashë, muj me ta dhënë informacioni, e nëse ti lyp raport me shkrim, atëherë ta bi edhe me shkrim. Ekremi tha, ka pas banor. Po kush nuk e diskutoj që nuk ka pas, ama ka pas shumë pak banor dhe tash kemi një ngarkesë jo vetëm aty kemi e krejt Vitinë një çështje të tillë dhe pamundësia financiare, se nuk e thash që nuk kemi me bë, ata jemi duke i shku proceseve mbrapa jo vetëm në si qeveri, ju kane shku të gjithë për shkak se ka qenë, e dimë rrethanat qysh kanë shku me përpara. Taulati tha, po flet si plakë. A flas si plakë a si politikan, këtu me vlerëson LDK-ja, ti nuk ki nevojë me më mesu mu me kënd bej koalicion. A tu kam përzi unë najherë, pse ti ke marr këtë hapë, krejt ato i merr përgjegjësi ti ato të cilat i kam marr në urdhëro. Nëse kem bë ndonjë gabim të tillë, ti e shfrytëzon në fushat, po megjithatë ty qysh po të gjason, jam tut gjasu si Hasan, si anëtar i kryesisë së LDK-së, nënkryetar i Komunës së Vitisë.

**z.Jakup Demiri:** Nënkyetari e tha, që problemin e Smirës e kemi trashigu si problem. Po ky projekt është ne dy faza, e cila faza e parë është kryer me herët ndërsa faza e dyte është kry ne kohen e qeverisjes se juaj dhe janë të ndara, nuk ka të bëjë ajo e kemi trashigu apo jo problemet me të mëdhaja i kemi në kanalizimin që është rregullu në qeverisjen e juaj, ndërsa një pyetje nuk e morra hiq për at kompaninë që i furnizn shkollat me pajisje higjenike. Më intereson edhe kjo.

**z.Ekrem Abazi:** Po e përsëris, ajo lagje dallon nga lagjet tjera. Sa i përket punësimit, du me thanë diçka, bile çdo parti politike gaton për me fitu atë moment që fiton duhet me marr me kushte të njëjta anëtarin e asaj partie bile nëse ke bë naj veprim shume të mirë Hasan Alia tash e morra vesh për kanë bëhet fjalë. Po në atë familje nuk ka të punësuar asnjë njeri, bile te koka bë shume pune me vend, po çka me bë për këta që i kanë të gjithë anëtarët e familjes të punësuar, paske bë një pune të mirë, se aty asnjë anëtar të familjes nuk ka të punësuar, ndërsa do që po folin që i kane të punësuar krejt anëtarët e familje, kjo është e tepërt.

**z.Ibrahim Rama drejtor i Financave:** Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket pyetjes se bërë nga Ekremi për kanalizimin tek rruga “Sherif Frangu”, gjegjësisht tek pompa e Alidemve, po është e planifikuar me



projektin e vitit 2020, po besoj që kemi me kry, se e dimë që ka problematika aty edhe nga konfiguracioni i terrenit, që ekziston aty po për hir të rëndësisë që kanalizimi duhet me perfundu në Komunën e Vitisë, kjo lagje është e projektume në planifikimin e buxhetit për vitin 2020. Ishte edhe një pyetje nga Taulanti kur është bë kërkesa për projektet për dy urat. Disa shënime i kam dorëzuar me shkrim. Nuk ka qenë i kënaqur me përgjigje sigurisht, kurse për projektin që ka të bëjë me renovimin e dy komunave të vjetra, unë do ta sjelli me shkrim, sepse pranimi teknik është bë para disa dite dhe nuk kemi pas mundësi me sjell. Tani për skjarim, të gjitha shënimet që kanë të bëjnë me projektin e urave janë publike, kontrata është publike, dosjet që kane konkuru operatorët janë publike, po në mënyrë specifike çdo kërkesë që kërkon ti specifikojë çka të intereson ty, sepse dosjen e kemi rreth operatorit ekonomik.

**z.Taulant Haxhiu:** Nën kryetar, nuk të thash unë plakë i katunit, po në atë kuptimin që ki pas shumë takime nëpër oda dhe din me fol.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Ju faleminderit të gjithëve! Tani po kalojmë tek rendi i ditës.

## R e n d d i t e

1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tret e Kuvendi Komunal.  
b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së e datës 07.05.2020.
2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), të Komunës së Vitisë 2021-2023. (Pa rekomandimin e KPF-së).
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme të komunës në shfrytëzim.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale afatshkurtër NPSH "Arena".
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim plotësimit të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim plotësimit të vendimit Nr.01-410/03-381, të datës 30.04.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2021
9. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutëm? Konstatoj se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

**z.Ekrem Abazi:** Kamë një propozim pasi që në KPF-ne, Korniza Afatmesme Buxhetore nuk ka kalu e keni prur pa vendim të KPF-së andaj propozoj që kjo pik sot të heket nga rendi i ditës se unë personalisht nuk do të jap kontribut dhe nuk do të rri në kuvend, shume shpejt kjo pik mundet me kalu po sot jo i kemi pas ne disa kërkesa nuk janë hy e sot kërkoj që kjo pik të terjeket nga rendi i ditës.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë jam i obliguar me qit në miratim rendin e ditës që ka ardhë nga ekzekutivi.

**z.Hasan Aliu:** I kemi dy pika të rendit të ditës në të cilat janë bë dy lëshime në aspekti ligjore kame bë përpjekje e kame përmirësu, po pasmi pas një keq kuptim me sekretarin e kuvendit kemi të bëjmë me piken 3 dhe 4 të rendit të ditës, se pika tre, dhënia në shfrytëzim e pronës me ankand publik, nuk ka të drejtë për katër vite, nuk duhet të shënojmë këtu për katër vite, për shkak se e shënon vetëm afatin afatshkurtër ose afatgjatë, tani masandej komisioni i propozon kuvendit e kuvendi e vendos. Aty me katër vite e kemi zëvendësu me afatshkurtër. Dhe tjetri propozim,

janë dy anëtar të qeveris komunale që edhe sipas meje si jurist nuk duhet me qenë, sepse janë pozicione politike po duhet të jen shërbyes civil. Këta janë dy ndryshime.

**z.Bekim Azizi:** E dimë që ka qenë një praktik edhe vitin e kaluar në seanca, të cilat pika që nuk janë rekomandu prej KPF-së, kanë ardh pa rekomandim dhe megjithatë e kemi tejkalu një gjendje dhe kemi ardh në gjendje stabile. Kisha kërku prapë mos të kthehet një gjendje e atillë, që me vazhdu me hi me inati. Po kërkoj ose e mbështes propozimin e Ekremi, që KAB-i të jeket nga kjo seancë dhe të vazhdon ne seancën tjetër. Përndryshe nuk do të jem pjesë e seancës.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë jam i obliguar me qit në miratim rendin e ditës, që ka ardh nga ekzekutivi. Nëse kuvendi është që të jeket nga rendi i ditës, do të jeket. Unë po e qes në votim rendin e ditës ashtu siç është propozu nga ekzekutivi.

**z.Jakup Demiri:** Edhe ne si Grup Parlamentar i LVV-së, po ju sugjerojmë që të terjeket nga rendi i ditës, për shkak që nuk ka kalua në KPF dhe nuk jeni ju për bashkëpunim. Nëse jeni për bashkëpunim, terjekne dhe bashkëpunojmë.

**z.Ekrem Abazi:** Rregulla është rregull. Po unë po të lus shoqërisht, se nganjëherë kemi kalu shpeshherë shoqërisht shume punë, ti e din edhe e dinë këshilltarët e tjerë, po të lus mos e qit, nëse e qet nuk kalon mbledhja thirrret me vohen nuk kalo edhe nuk ka me të kalu, prapë unë po të lus mos e qit në votim.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Kërkoj 10 minuta pushim të konsultohem me shefat e grupeve parlamentare, atëherë me qenë se kalun 10 minuta, kërkoj që të zini vendet e të fillojmë me mbledhjen. Patë propozime, që nga rendi i ditës të terjeket propozimi vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), të Komunës së Vitisë 2021-2023. (Pa rekomandimin e KPF-së), unë u konsultova me kryetaret e grupeve parlamentare dhe natyrisht nuk morra ndonjë përgjigje të saktë. Disponimi është që të terjeket nga rendi i ditës kjo pikë, mirëpo si kryesues i kuvendi komunal kemi të bejm me Kornizen Afatmesme Buxhetore dhe afatet i kemi qaq të limituara që nuk mundemi me thirr seancë të jashtëzakonshme, për faktin që me datën 30 jemi të obliguar me e dërgu Kornizën ne ministri, nuk po ka mundësi, se vullneti është me shty. Unë po ju lus në aspektin shoqëror që ta kalojmë KAB-in, sepse një pjesë dikun 70% e këtij buxheti që është e dedikuar për qytetarët e Komunës se Vitisë, është paga dhe mëditje, që natyrisht janë edhe pagat e asamblistëve. Unë kërkoj ta votojmë rendin e ditës dhe të hecim tutje. Po e ritheksoj edhe njëherë, e kam pas vullnetin 100% me thirr seancë të jashtëzakonshme. Sikur ta kishim pas afatin ligjor, po për shkak të pamundësisë, ju lus ta votojmë këtë rend dite.

**z.Sokol Haliti Kryetar i Komunës së Vitisë:** Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kisha thanë që mos me i shpeshthu takimet pa nevojë, kur të kemi mundësi me i përfundu sot, pasi përbërja e kuvendit komunal është prezent. Unë e kisha kuptu të gjithë ata që mendojnë ndryshe, në rast që kishin bë kërkesa. Sa i përket KAB-it, e na nuk i kishmni fut në kornizë, atëherë ka qenë vërtet arsytimi i plotë, po nëse nuk ka kërkesa, nuk është mirë me e shty për shkak të afateve që i kemi, përndryshe KAB-i është më e mira që 20 vitet e fundit, se kemi rritje në tre parametrat kryesor që nuk i kemi pas asnjëherë. Kjo është meritë e punës së përbashkët që e kemi bë, edhe qeveria edhe kuvendi. Sferën e bujqësisë, shëndetësisë, shërbimeve publike, që lidhet edhe me krejt sferat e tjera, me aspektin ambiental, mirëmbajtjen e objekteve arsimore, shëndetësore, sepse parametrat që po i rrisim ne në infrastrukturë, kërkojnë vërtetet mirëmbajtje e mbikëqyrje. Edhe ndriçimi e të gjitha aspektet e tjera, janë jetike për neve, prandaj nuk guxojmë me e lendu veten e me dobësu veten, tek KAB-i e me shku të lënduar, atje i kemi afatet, limit, nëse është nevoja, unë u konsultova me bashkëpunëtor dhe nuk ka kërkesa me pas kërkesa konkrete. Unë erdha për qata, në mënyrë që me i bisedu kërkesat dhe me i inkurpuru, e nëse nuk ka kërkesa, vërtet është e panevojshme me e shty. Unë ju kisha thanë me e votu, vetëm nëse ka kërkesa, cili do grup parlamentar, sepse KAB-i nuk është e një grupi, ajo është e përbashkët, është e qeverisë komunale, është e kuvendit, nuk është problem me i inkurporu kërkesat e juaj nëse janë parimore e ligjore. Vetëm kame dëshirë si kryetar komune, me ditë për cilin aspekt kemi ne mundësi me e përmirësu gjerat, cili do propozim që vjen nga cili do grup parlamentar, vetëm le te kërkon, cili është propozimi ne cilën lëmi, cilën sferë, cilën rritje, cilën zë buxhetor, ku janë ndryshimet, ku muj me bë përmirësime apo ku kemi efektshmeri. Nëse bëjmë transferim, më shumë kjo është kërkesa ime, përndryshe,

nëse nuk e bëjmë këtë, nuk e di cila është arsyeja për mos me e votu. Prandaj, po ju lus, mos ta hupim afatin, pasi edhe kemi përmirësime me të mira në sferën e bujqësisë, kemi për 150 mije euro, për 150% faktikisht i kemi rritje, në shërbime publike kemi rritje, ne shëndetësi në tri parametrat kryesor kemi rritje, prandaj në këtë kuptim ju lus me e votu KAB-in, me e zënë afatin ligjor, edhe ashtu kemi probleme dhe regres në Kosovë dhe ne veçanti në Viti, sepse edhe ne varem nga të hyrat vetanake dhe nga grandet qeveritare, ku kemi zbritje të mjeteve prej shumë kodeve buxhetore, kemi lëndime të projekteve dhe implemtimi ka me qenë shumë i rand, e mos ta dëmtojmë më shumë procesin e rregull financiar dhe orientimet e drejta buxhetore për të ardhmen. Është një orientim që është meritore edhe kuvendi barabartë me qeverinë. Unë mendoj, që është më i miri, na ka mundësu rritja për 470 mije euro, andaj këtë kuptim mos ta hupim afatin.

**z.Ekrem Abazi:** Unë po e përsëris, për sot nuk do ta votoj, thirrne kur të doni KPF-në edhe bisedojmë dhe kjo pune kalon, po sot nuk kalon edhe tek afatet që po thirrni, është koha e pandemisë, nuk kshyren bash ashtu afatet.

**z.Bekim Azizi:** Na e dimë që 6 vite buxheti që është miratu me propozimin e juaj, asnjëherë nuk ka mujt asnjë shkronjë me ndryshu nga ky kuvend dhe kjo pauzë kryesues, nëse është bë për me ja bë një argat kryetarit me ardh këtu me tregu presion, që me votu, kjo unë mendoj që është gabim i juaji, kryetari është mirë me ardh në seanca, ne fillim në piken e parë kur bisedohen çështjet e qytetarëve, problemet që ngritën është mirë aty me ardh me përball me neve, mos mi lan në siklet nënkryetarin e drejtorët, ndërsa kur kalon tek pikat e rendit të ditës, mendoj që është pune e kuvendit që na i diskutojmë. Kryetari sot kërkon propozim me i inkorporu ne KAB. Vonë është tani, e kemi qe duhet të respektohen organet që i zgjedh ky kuvend, e kemi që ta bëjmë një traditë të mirë, që t'i diskutojmë njëherë dy tri, sa herë do në KPF të kalohet e të vimë këtu t'i kalojmë bashkë. Ky është qëllimi i jonë, t'i respektojmë organet tona që i kemi zgjedhë, mos të shkojmë ma si ti vjedh pikat. Kësaj radhe kjo pikë nuk duhet me kalu.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë nuk e kame thirr kërkon, as kryetarin as kerkan. Kryetari e ka të drejtën ligjore me marr pjesë në seanca të kuvendi, sepse në një mënyrë propozus i rendit të ditës është kryetari i komunës.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Unë i di obligimet e mija kushtetuese, po kisha obligim kushtetues me e udhëheq komitetit emergjent në ora 10:00, që tash e 108 ditë u mbajtën këto mbledhje. E dinë edhe ti këtë, e ju falënderoj edhe juve shëfave te grupeve parlamentare që jeni kujdes, sepse të gjithë bashkë e kemi menaxhu pandeminë në Komunën e Vitisë që 108 dite. Jam ardh ne kuvend, jo që me ka ftu kryesuesi, e kam lajmërua sekretarin, se do të jem pjesë e punës, po masi e ceke ti piken e rendi të ditës së parë, unë po ju thamë që jeni tu i thy rregullat shume rrast. I kam thanë kryesuesit, Ligji për Vetëqeverisje Lokale piken e rendit të ditës e trajton në mënyrë ligjore. Pika e rendit të ditës, pyetje dhe përgjigje është e përcaktume me ligj. Unë i kam thanë kryesuesit, ti duhet me e zbatu ligjin, rregullore është statuti, pika, pyetje dhe përgjigje, në të cilën ju po i kushtoni rendësi. Shumicën e kohës së kuvendit e harxhoni me qatë pikë, unë kam dashtë me i dhanë karakter punës së kuvendit, sepse ju kemi furnizu me pika vazhdimisht, kurrë nuk keni pas mungesë prej qeveris me pika të rendit të ditës. Shikoj kuvendet tjera a mujn me i mbajt 12 mbledhje, edhe nuk janë në siklet drejtorat, mos tu dhimben hiç, se janë tu punu 7 ditë në javë, vetëm që 108 dite kane qenë 7 dite në javë në punë, nga 17 ore në ditë. Nuk janë siklet asnjë ata që janë kompetent dhe që e kryen punën me nderë, në interes të qytetarëve, asnjë nuk janë në siklet, qytetarët krejt i mbrojmë, po dikush ka barrë më shumë, sepse ka edhe vota më shumë dhe ka përgjegjësi më shumë. Edhe ne kemi qenë opozitë, po ne e kemi votu gjithëherë KAB-in, e dini ju që keni qenë në kuvend, po kur kemi pas kërkesa i kam dërgu propozimet. Kam mëndu që i pranoj edhe nga ju. Unë në fillim thash, nëse ka propozime për ndryshime, unë jam në gjendje me i pranu me bisedu, a muj me i fut në zëra buxhetor. Nuk shtyhet votimi vetëm pse po ju teket dikujt, po ta thamë miqësisht dhe zyrtarisht. Ekrem vetëm që tu mteket ty nuk terjekët kjo pik e rendit të ditës. Unë mendoj që ne të gjithë së bashku e kemi një interes qytetar, do korniza afatmesme buxhetore, buxhetin, e do aspekte tjera që janë kruciale per me hec përpara komuna, ku varen edhe rrogat e qytetarëve edhe projektet, infrastruktura. Edhe njëherë po ju thamë, nëse nuk ka propozime, është dashtë me votu, e nëse ka propozime, duhet me i shqyrtu. Nuk po di si me ju than me sinqertë.

**z.Ekrem Abazi:** I përmende teket. Shumë e vërtet që i kam teket e mija, po atë ditë që nuk u terjek kjo pik e rendit të ditës, atë ditë kam than që unë nuk e votoj, nuk po i përzihem kërkujt, le të voton si të dojnë. Unë nuk e

votoj. E që po thu për qytetarët, krejt të njëjtë, në këtë kuvend thuhet fjalë shume të ëmbëlta, po puna është krejt ndryshe, nuk keshyren qytetarët, njëjtë na jemi të barabartë vetëm kur jemi tu i kalu pikat. Absolut nuk jemi të barabartë. Do familje shkelen si mu pas kanë familje të Milloshoviçit, shkelen vetëm që nuk ju përkulen kurrkujt para kamve, nuk ju kam përkul shkavit në luftë, e ka muj me më myt. Krejt po duhet pak me pas ftyrë, jo vetëm kur të jesh në zor, po duhet me qenë na njerëz, se e di çka keni bë ju e ata tjerët, që 20 vite jam këtu, e di. Teke nuk po thamë, po është e vërtet që kam edhe teke. Kërkujt nuk ju përzihem unë, thash që në at pikë nuk kontribuoj, dal prej kuvendi dhe votoj kundër e nuk i bi pishman kurrë për këtë për kurrnifarë çmimi. Thirrne mbledhjen një ditë tjetre, ka me kalu, ama edhe unë i kam teket e mija si që e keni ju, që po e shkeleni dikan në qaf.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Mirë që po e pranoni që ki teket e tua, e për shkak të tekeve tua ti po donë KAB-in me e lanë pa e votu. Unë kesh i saktë, po për dallim nga ti që po flet fjalë, unë po thamë që kurrë më shumë se tash nuk është punu për interes të qytetarëve, edhe besa gjatë pandemisë kurrë nuk është punu për secilën familje, më shumë për secilën fshat, për secilën lagje, edhe është tu punu shumë në interes të qytetarëve edhe këtë po e vlerësojnë qytetarët, edhe shumë kanë me e vlerësu. Unë i kisha lut këshilltarët, shefat e grupeve parlamentare, që merrne me seriozitet punët institucionale, që janë sidomos ato që trasojnë rrugë, që plotësojnë nevojat për interes të qytetarëve. Ju lus me rujt nivelin e debatit në kuvendin komunal, me rujt kulturën, ju lus me votu KAB-in, për shkak që është në interes të qytetarëve të Vitisë. Nëse keni ndonjë propozim për ndryshim, ejani e shikojmë bashkë, e nëse ju mendoni që na nuk po e marrim kërkesat e juve, atëherë ju kisha kuptu ndryshe, e nëse nuk keni ndryshim me bë najë ndryshim, atëherë ju lus ta votoni KAB-in.

**z.Vehbi Rama:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fatkeqësisht në këtë kuvend po shifet që po shkon me lutje, lut këshilltari, lut kryetari me teke të këshilltarit, me teke të kryetarit. Fatkeqësisht ku jemi mbet në këtë kuvend, me lutje nuk shkohet, po shkohet ashtu qysh është që me votu gjithmonë për interesa të qytetarëve. Nja kisha me pyet, edhe kryetarin edhe kolegun tim këshilltar, që sot nuk kalon, do të thotë që nesër kalon. Pse sot nuk kalon e nesër kalon. Kryetari dhe kryesuesi e thanë, urdhëro e bëjmë ndryshimin, kërko çka me ndryshu edhe e thirrmi nesër një seancë. Unë nuk po e kuptoj këtë, edhe unë jam në koalicion, e po bi në pozitë të keqe, jam shef i grupit të AAK-së, e tash me ra në pozitë të keqe. Unë nuk e lejoj, urdhëro koleg, propozo ti çka me e ndryshu.

**z.Bekim Azizi:** Nuk është koha me lyp propozime, se hala nuk kemi hi në pika të rendit të ditës, kur ta shqyrtojmë kornizën buxhetore, atëherë japim propozimet, e aty votohen se çka ndryshojmë e çka jo. Propozimi është kanë, që të jeket kjo pikë prej rendit të ditës, sepse nuk ka kalu në KPF-në, kjo është arsyeja edhe aty në KPF i kemi dhanë arsyet e tona. KAB-i është për qytetarët, është për vendin, po t'i përmbahemi rendit.

**Kryetari z. Sokol Haliti:** Nuk po du as unë me repliku, ama ju po i gjuni fjalët e rënda, e tani po thu mos fol, ku mos me fol, përderisa ti më thua mua ki shpijuna. Bekim, nuk është nivel i një intelektual ky që e thua ti. Unë po du me i tejkalu këto. Çdo njeri që është këtu, është më detyra, janë drejtorët, janë zyrat përkatëse, prandaj nëse kam të tillë çfarë tha këshilltari, atëherë është temë tjetër. Unë muj me ngrit këtë çështje, e me pyet kanë e kam, po nuk është mirë me ngrit kësi çështje.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Prezent në sall i kemi 26 këshilltar. Kush është që të miratohet rendi i ditës? Me 13 vota pro dhe 13 kundër, me votën e dyfishtë të kryesuesit të kuvendi komunal. Kalon miratimi i rendit të ditës.

Pasi që nuk kemi korum, e shty seancën për një datë tjetër.

Atëherë po vazhdojmë me seancën që e kemi ndërpre dje. Mirë se keni ardh në këtë seancë.

### **Pika e parë e rendit të ditës:**

#### **1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tret e Kuvendi Komunal**

#### **b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, e datës 07.05.2020**

**z.Ali Bajrami:** Unë vetëm deshta tek faqja nr.18, ku kam thanë për emrin e profes Qahil, e këtu është i profes Remzi. Vetëm këtë ndryshim.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat rrethe procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratuan procesverbalet.

**Pika e dytë e rendit të ditës:**

## **2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), të Komunës së Vitisë 2021-2023. (Pa rekomandimin e KPF-së)**

**z.Ibrahim Rama drejtor:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, më 15 maj kemi marr qarkoren e parë që ka të bëjë me fillimin e procedurave për draftimin e fundit të buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2021 dhe projeksionet për vitin 2022-23. Kjo është përgatitja, fillimi i dinamikës së përgatitjes së buxhetit, i cili duhet deri me 30 shtator të miratohet në Kuvendin Komunal të Vitisë. Është një prej dokumenteve me kryesor që miratohet nga ju të nderuar këshilltar komunal, për arsye që në momentin që miratohet në kuvendin komunal, ai e merr formën e ligjit mbi zhvillimet e procedurave të ekzekutimit të buxhetit për vitin aktual dhe projeksionet për vitin 2022-23. Unë për fillim po ju tregoj, që kjo është hapi i parë i KAB-it. Ju e keni marr materialin me kohë dhe e keni konsultu. Është një hap i parë në rrugëtimin e përgatitjes së buxhetit. Kemi plotë procedura, kemi kohë në dispozicion, që duhet të fokusohemi në këtë drejtim. Në KAB-in e kemi miratu në bordin e drejtorëve, e kemi procesin në KPF-në dhe sot është para juve për miratim, që me e dergu në Ministri të Financave, deri sot ne e kemi kry procedurat e tona. Buxhti për vitin 2021 në bazë të ndarjeve buxhetore që janë bë nga niveli qendror kap shumë prej 12 milion e 776 mijë në këtë shume janë të përfshira tri grande dhe të hyrat vetanake që e kanë me ligj të obliguar komunat me i inkasu gjatë vitit fiskal. Grandi i përgjithshëm për vitin 2021 është 4 milion 774 mijë, granditë specifike i arsimit është 5 milion e 425 mijë euro, dhe granditë specifike i shëndetësisë është 1 milion e 508174 euro dhe të hyrat vetanake janë të planifikuara të grumbullohen këtë vit 948 mijë e 599 euro. Kryesisht kur të grumbullohen këto është planifiku një buxhet pra prej 12 milion e 776 mijë. Për vitin 2022 janë planifiku 14 milion e 296 mijë euro dhe për vitin 2023 janë planifiku 14 milion e 71000 euro, pra këto janë shifrat që janë përcaktu me qarkoren e parë në bazë të planifikimit dhe ndarjes buxhetore sipas grandeve për të gjitha komunat në nivel të Kosovës. Materiali e keni marr me kohë, për pyetje shpesh jam në dispozicioni e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pik të rendit të ditës.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje! Drejtori e elaboraj KAB-in, është dokument ligjor që duhet respektuar afatet kohore dhe ligjore për hartimin e draft buxhetit të viti 2021 dhe parashikimet për vitin 2022-23. Vlera totale 12 milion e 776 mijë euro, është një rritje prej 470 mijë euro, është ajo që na ka taku nga niveli qendror, kur është nda edhe kjo përqindje që na u ka dhënë. Nëse ndalim e shofim përqindjen e buxhetit, paga është 67% dhe shërbime e mallra 15% dikunde 82% a mundemi të jemi të kënaqur se ma tepër është buxhet i konsumit se sa zhvillimor. Çka na mbetet tek kapitalet, që janë 13%, të bëjmë përpjekje që ti rrisim të hyrat vetanake, se janë mjete që mundemi direkt si komune t'i adresojmë dhe ti shfrytëzojmë aty ku kemi nevojë. Prandaj tjetra që janë subvencionet, është 3% dhe shpenzimet komunale 2%. Ajo çka vlen për tu cek dhe është për tu përshëndet, është se kemi rritje për shërbime dhe mallra 200 mijë euro, shëndetësi 80 mijë dhe subvencionet që e prekun direkt prodhues që rritet vlera për 100 mijë euro. Ajo çka mungon, është tabela e projekteve të investimeve kapitale, po kjo është shkaku që nuk kanë përfunduar debatet në lokalitete. Me përfundimin e debateve, edhe kjo do të kompletohet dhe në seancat e radhës kur e kemi edhe miratimin e buxhetit në shtator do të jetë complete dhe do ta bëjmë një kornizë afatmesme buxhetore ashtu qyshe është e parapamë dhe qyshe e mundëson ligji.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ne dje me plotë të drejtë e lëshuam seancën, për arsye se këto janë të gjitha rekomandimet që i ka dhënë LVV-ja qyshe vitin e kaluar, lidhur me buxhetin, nëpërmjet përfaqësuesve tone në KPF, zonjushës Liridona dhe Jakupit, asnjë nuk e keni marr parasysh, ndërsa kur jemi tek kërkesat e qytetarëve, jam dëshmitar që sa herë kam insistu që të hapet kanali në "Lagjen Zejnullahu". Kam pas marr drejtim publik edhe nga ju, prandaj kur është në pyetje për dëgjime buxhetore, shume pak ka met me ju besu, edhe pse jeni ka të parët të vlerësuar sipas Institutit Demokratik, që i keni mbajtur dike rreth 26 dëgjime buxhetore, mirëpo me pas qu hollë e hollë, plani zhvillimor komunal i arsimit, asnjëherë nuk e kanë bë, duke fillu nga drejtori i arsimit që na neglizhon dhe nuk vjen këtu me ndëgjju, për arsye se e ka obligim ligjorë në bazë udhëzimit administrativ që e përcakton shume mirë dhe me ditë saktë se buxheti askun nuk ka më shumë se sa në arsim. Faleminderit edhe Qeverisë Kurti, që zotria Besnik Bislimi ka bë ngritje në grandin e përgjithshëm për Komunën e Vitisë, një prej personave që ka be zhurmë më së shumti, që Vitia mos të diskriminohet me buxhet, kam qenë unë. nuk e kam thanë unë, po e ka than Instituti GAP. Bazë hulumtimeve, këtë vit po më bëhet qefi që 400 mijë euro janë buxhet shpesh në Komunën e Vitisë, si dhe është evidente drejtor, ka komuna të cilat kanë bë hulumtim, ju nuk e dini sa është ndikimi i pandemisë së Covidit në buxhetin edhe ashtu të varfur të Komunës së Vitisë, nuk e keni

idenë absolut një shifër nuk keni mujt me naj ofru nëse zotri Besnik Bislimi ka thanë se në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2021-2023 që është aprovu me 30 Prill 2020 ai thotë që do të ketë ramje të të hyrave vjetore për 5.3%, për shkak se ka pas një aktivitet me të limituar ekonomik, atëherë edhe unë kame të drejtë me i besu për arsye se është profesionist i fushës, kur analizohet si tërësi. LVV-ja fillimisht insiston për arsye se viti i ardhshëm është vit elektoral edhe ne e dimë se si shtrohen asfaltet, si merret vota me një rimorkio me zhavorr ose me favore tjera. Prandaj, si LVV nëpërmjet Jakupit i kemi artikulu kërkesat rekomandimet në KPF-në dhe këtë vit dojmë garanca që ta kemi listën e investimeve kapitale. I keni bërë shtat vite qeverisje, i keni listën e prioritetëve në të gjitha fshatrat, janë përsërit vit pas viti, pastaj siç jam dëshmitare, sepse kame marr pjese edhe në dëgjimet buxhetore në fshatin Skifteraj edhe saktë e di përafërsisht se cilat kërkesa janë përsërit. Prandaj, fillimisht po dojmë me besu edhe me marr garanca, se ki me pas listën e investimeve kapitale. Nuk është arsye që nuk e ki. Kam hulumtu kogjo shumë për buxhetin e komunave tjera, të kornizave të tyre, shume bukur i kane të ndarë dhe të specifikuara, nuk është keq me marr shembull edhe nga komunat tjera kur janë të mira e ki sa investojnë prej grandit specifik, sa prej të hyrave vetanake, sa investime parashihen neve edhe buxheti kur na ka ardh na ka ardh në mënyrë të akumulume, 500 mije euro asfalt, që shtatë vite asfalt, asfalt, a që ku e kemi në gjendje të mjerueshme, mu vin nxanesat me ankohen e për këtë arsye LVV-ja është këtu për qytetarin. Ne nuk bëjmë pazare, ne jemi zëri i qytetarëve, ashtu qysh jemi zotu para tyre kur kemi kërku votë për atë arsye LVV-ja i ka 8 kërkesa, po fillimisht po thamë listën e investimeve kapitale, e listën e prioritetëve të këshillave të fshatrave ndoshta për shkak të pandemisë listën e prioritetëve të këshillave të fshatrave nuk mundesh me pas, mirëpo me qenë se është vit elektoral, ne dëshirojmë që kërkesat tona të merren parasysh, të na jepet lista e investimeve kapitale, e para është edhe shumë e domosdoshme, që gjashtë vite asnjëherë nuk i dhatë epilog ujit të pijes. Çka ka më të rëndësishme se me i pa njerëzit në komuna me kamta, tu shku me marr ujë, a shtrohet asfalt që harronhet pas tre muajve. Kjo është mjerim. Nuk po flas politikisht, po flas si zë i qytetarit. Rritja e kapacitetit të fabrikës për përpunimin e ujit në fabrikën e Letnices ku do të kyqen edhe fshatra tjerë me rritjen e kapacitetit të volumit të ujit, në këtë rast edhe Skifteraj edhe Budrika edhe Remniku. Uji është jete. E dyta, përkrahja nga 100 euro për gratë lehona, të gjitha vitin 2014. Doktorësja Gjylë, shume mirë e din si grup i grave, ka qenë d.m.th kërkesë e të gjitha subjekteve politike, asnjëherë nuk e keni marr parasysh, i ndjeri Ibrahim Sefedini shumë herë ka shkru në kohën ditore, po kurrë nuk është marr parasysh, prandaj këtë rast tu e pa ramjen dhe tu e pa gjendjen sociale, kjo është kërkesë e LVV-së. Në tre, subvencionimi i udhëtimit të nxënësve të shkollës së mesme të fshatit Debellde. Kolegë të nderuar, jam dëshmitar vet, se shumë nxënës të fshatit Debellde janë të detyruar ta lënë mësimin për shkak të distancës që është nga Debelldehu. Dikun rreth 14 kilometra, jam dëshmitar që disa nxënës e kane lan mësimin shkaku udhëtimit. Ju mund të arsyetoni se nuk keni të drejtë, mirëpo mund të gjinden forma se si të subvencionohen këta fëmij, e mos të na mbesin jashtë bankave shkollore, se është e dhimbshme në fushat. Fatbardha ka pas premtu, publikisht e ka thanë, ka reagu zonjusha Liridona. Kërkesa numër katër, ndërtimi për çerdhen publike në Viti. Kërkesë numër pesë, shujta për fëmijët, për parafillor, edhe prej klasës së 1-5 të subvencionohen nga komuna, jo fëmija të paguna 5 euro për një kilfe. Kërkesa numër gjashtë, fondi i veçantë për OJQ-në Hendikos, që të funksionoj si OJQ. Një ndër kategorit e personave të cilët janë më së shumti të diskriminuar, janë këta kategori. Ne kishim raportin në seancën e kalume, aty u cek, që asnjë eskurizion nuk ju ka subvencionu. Kërkesa numër shtatë, renovimi i tërësishëm i tet kabineteve si dhe funksionalizimi i kabinetit të dizajnit. Nxënësat tonë nuk kanë ku ta kryejnë praktikën, janë në gjendje të mjerueshme. Unë fëmij tim qetu nuk e kisha lan tmerr. Kërkesa nr. tetë, ndërtimi i aneksit të sallës së edukimit fizik, tek gjimnazi. Kërkesa e profesorëve të edukatës fizike, pasi që vij edhe nga ajo fushë, nxënësat orën e edukimit fizik, kur janë temperaturat e ftofta, nuk lejohet, prandaj këto janë kërkesat, e nëse nuk merren parasysh, ne si LVV edhe do të votojmë kundër edhe do ta lëshojmë seancën.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Është mirë kryesues, me gjithë respektin që po bënë përpjekje maksimale me e mbajt renin, ky fjalim të cilën e ke përgatit sot ti, e që ju drejtove këshilltarëve komunal, shumë herë e përdore termin tmerr është atje. Ti sot i ki tmerr, ku këshilltarët me diskutimin, çka i bënë përshtypje këtyre Besnik Bislimi, a u kanë ministër i mirë apo nuk është kanë, merru me kompetencat të cilat i kemi ne këtu, cilat janë ato që janë këtu. Si këshilltare e kuvendi komunal, propozimet e juaja gjithherë janë legjitime, po njëherë e përgjithmonë po e kalon mandatin e dytë, duhesh mu mesu, se kryetari i komunës ka një program dhe ti në rast që mendoj që ja inponon që kanë me hi qeto, se përndryshe do ta lëshojmë seancën. Lëshoje lirish, ajo është në ndërgjegjen e juaj. Do të përgjigjesh para atyre që të kanë votu, po kryetari i komunës ka fitu me një program elektoral ,që ju ka drejtu qytetarëve, dhe qaj program është përgjegjës për me e realizu, është edhe para

qytetarëve, është edhe para atyre matësve të cilët masin premtime që i ka dhe çdo ditë e shikojmë, po ato të cilat ti me gjithkush si gratë lehona të kenë pagesë, po ai është rekomandim i grupit të grave. Ti propozove nga 100 euro, edhe unë me qef i kisha dhanë nga 1000 euro, por duhet të shiqojmë në rast se ne e kemi qenë dhe kemi lyp votë prej dikujt, duhesh tashti ta shiqojmë mundësinë buxhetore, prandaj shtrohet këtu buxheti me e keshyr a janë ato mundësi. Buxheti nuk është fontan dëshirash me e realizu, se po kam qenë unë qeshtu. E thave tmerr është atje. Prej atij tmerri qekjo qeveri të ka pru këtu, edhe po e mban shume komod. Do t'i vjen koha edhe asaj të rregullohet. Thave që VV-ja të koka për qytetar, e na për kanë jemi. Këto janë ofendime, po i ofendon krejt, se vetëm VV-ja të koka për qytetar. Ekremi i ka 5 mandate, unë jam prej mas lufte, e unë për kanë jam, për stuba. A ma mos bën hajgare, je profesoresh e këshilltarëve, nuk bënë asi diferencimi me bë. E tha do të jetë vit elektoral. E dimë që do të jet vit elektoral, ne nuk e kemi kalu vetëm një fazë elektorale, ne kemi kalu që 20 vite jemi në mandat e vit elektoral, por megjithatë rezultate që janë, shini, janë rezultate që duhesh mu u ni krenar edhe ti se je kanë pjesë e kuvendit. Uji i pijes, e kemi tha 100 herë, se uji i pijes nuk varet vetëm prej komunës, po të ish var vetëm prej neve, po të ishmi në Prishtinë dhe ti kishim ka 30 milion suficit, po neve nuk po na dalin, se janë nevoja të shumta që po mujmë me i hargju, po uji, janë tri komponentë që duhet me u involvu, është komuna, është CDI-ja, Ministria që e kemi këtu, atë këshilltari që e dinë për mrekulli, është komuniteti, prandaj gjithherë këtu hasin disa pengesa, edhe ne nuk jemi të knaqtë me at zhvillim, me atë ecuri që është tu shku. Kemi takime gati javore, të cilat janë takime shumë të mundimshme për me i shty këto procese, po është kjo gjendje dhe ti e thu uji i pijes ka ngel dhe keni nga në asfalte. Po edhe në asfalte jemi kanë në lloq. Më mirë me hek njëherë e përgjithmonë. U tha për subvencionimin e nxënësve të shkollës në Debulde, kurrë nuk kemi thanë që nuk banë me i bajt, po ligji po thotë, ligji po thotë obligative deri në klasën e nëntë, prej aty po konsiderohet të mitur, të rritur, të cilët munden me bë zgjidhje. Gjithçka tash çka bëjmë aty edhe kur i kemi bajt na edhe na kemi bë politik edhe ti po bën politik. Tash gjama ti një rrugë ligjore. Unë po e zbatoj, po ti nëse si këshilltar e kuvendi komunal dhe je për me më thanë mos e shkel ligjin, duhesh me më thanë edhe këtu mos e shkel ligjin.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Po kur të ju bjen mirë juve, hiq nuk pritoni me përmend qeverinë, kur të jeni ju në qeveri, se sa jeni të mirë për qytetarët u pa në kohë të pandemisë, e rrezikut qeverinë Kurti, e qysh e kanë vlerësu qytetarët, i kanë qit të partë, mos harro, LVV-ja është e para dhe prapë do të del bindshëm e para. Ju dje thojshit cilat janë ato kërkesa, e kur i paraqitem tani kërkesat, po thuni që keto nuk bejn, na tregoni, a nuk është e rëndësishme uji. Çfarë arsytimi mundesh me gjete, që pas shtatë vite mos me pas ujë. A sa e arsyeshme me kerku për nxënësia shtatë vite. Nuk gjete hapësirë me investu, na shtrut asfalte që prishen mas tre muajve. Harrohen, qeto jane kërkesa që i keni kerku dje.

**z.Ali Bajrami:** Tek KAB-i në faqen nr. 9, i kemi vlerat e vitit 2019, 2020, 2021, 2022. Nuk po du me bë politik nacionale, se jemi të zgjedhur për politik lokale dhe me i mbrojt interesat e qytetarëve të Komunës së Vitisë. Nëse i shikojmë tabelat, në vitin 2019 janë kanë 11 milion e 399 mijë. Vitin 2020 është 12 milion e 305 mije. Vitin 2021 është 12 milion e 776 mije. Vitit 2020 është 14 milion e 296 mijë. A jam i knaqtë me këto rritje, nuk jam, pavarësisht kush është kryeministër. Për momentin nuk është ai që parafolësja e përmendi, po nuk është me rendësi kush është ne viti 2020. Ketë rritje të buxhetit, është pak se kemi nevojë për shumë më shumë.

**z.Jakup Demiri:** Përsëndetje për të gjithë! Nënkryetar, po me vjen keq, po ti nuk ki të drejtë me na tregu neve se qysh flasim dhe si sillemi, na jemi vetvetja, të votuar nga qytetarët. Nuk kam nevojë me tu përshtat unë ty. U tha që po bëni politika nacionale. E vërtetet që jemi nivel lokal na, po politikat nacionale prej atje varet tu fillu prej investimeve kapitale, grandeve, se sa për nivel nacional ne fillim ka qen kryetari ai që u merr me këtë punë. Tek votat, u tha që i ka kryetari, e pse dje nuk i pat votat për me e kalu, po u deshtë sot me ardh na. E dimë me një të kalume se si janë siguru votat, me lloj lloj dallavere e keni kalua buxhetin çdo vit, na e kemi një praktik me juve. Tek prioritetet tona. Ata nxënësit në Debolle, sa shtoni asfalta nëpër shpia private, qoni bre atje më mirë është qytetari jeton me se pari me ujë të pijes, me rrugë, me kanalizim, me rrymë. Kjo është infrastruktura bazë e qytetarit, që gjashtë vite me këtë qeveri, nuk pash asnjë qeshmë dikun tu e leshu, janë pyetje për 100 mijë euro. Na qe jemi kanë tek "Hidromorava", që duhet mu investu në fabrikën e ujit, atje dhe ka ujë të mjaftueshëm. Asfaltet pas dy tri jave ju prishen krejt dhe kanë pranim teknik, a qytetari nuk ka ujë me pi. Ne i kemi pas rekomandime, ju kemi dorëzu vitin e kaluar të shkruara, nuk e keni pas vullnetin as me i lexu, sot i kemi disa nga to. Të jemi të sigurtë, nuk i kemi shti krejt për qata na jemi për qytetarët, sepse e dimë që jemi në vit pandemik dhe nuk ka mundësi krejt ato mu implementu, edhe ju disa që i votoni disa vendime pa i lexu hiq na e dimë këtë.

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje per të gjithë të pranishmit! Kur po diskutojmë këto dokumente, unë do të kthehem tek deklarimi i kryetarit. Po të ishte kryetari këtu, me siguri se do të ja përsëritsha fenomenin e Diogjenit. E kam pas tregu njëherë, e din kryetari këtë punë dhe më shumë vëmendje e kam dëgjuar dje kryetarin ka flitke dhe çfarë thoshte, përderisa një pjesë e argatëve të tij, me falni që po ju them argat, se një pjesë bukur e mirë e atyre që thash argat, përderisa unë kam dëgjuar kryetarin me vëmendje, ata lujshin në telefona dhe si të doni ju jap fotot. Pasi që sa kryetari këtu, po ju drejtohem nënkryetarit. Të lutem, neve shpeshherë po na akuzon që po përdorim fjalor jo adekuat, po nuk e di unë se çfarë fjalori është ky të thuash se kërkesat e grupit të VV-së janë fontan dëshirash. Nënkyetar, ato nuk janë fontan dëshirash, po janë kërkesa të cilat qytetarët në na kanë adresuar, çoftë edhe ata qytetar që juve ju kanë votuar e jo neve. Prandaj në përfaqësojmë këtu krejt qytetarët, e jo vetëm ata që na kanë votu neve. Kryetari shumë kjarit dje e tha, se paraqitni kërkesat e juaja dhe ne do të merremi vesh të hecim tutje. Po çka bani kryetari sot, me siguri ka naj takim, sepse sa këtu. Krejt ajo çka u tha nga nënkryetari, të jep me nënkuptu se kërkesat e VV-së nuk janë të dëshiruar apo nuk janë të pranueshme për kryetarin, apo për qeverinë komunale, dhe pasi që ne mendoj që ju po na largoni nga kuvendi e jo ne, pasi që dje nuk kishin siguri që do ta votoni këtë pikë të rendit të ditës, kryetari na ofroj oferta që të mirrmi vesh e kur të himë tek pika e rendi të ditës do t'i shqyrtojmë kërkesat e juaja, e unë sa po marr vesh e sa po shoh këtu nuk ka fare disponim që të diskutohen këto kërkesat e grupit të LVV-së. Andaj unë jo qe kërkoj që të dalim nga salla, mirëpo me insistimin tuaj po na largoni nga salla.

**z.Hasan Aliu nënkryetar:** Remzi, nëse ke mundësi me me ndegju, sepse akuzave në adresën time, prit, merr përgjigje, nëse pajtohesh mirë, përndryshe nëse nuk dëgjon, sa për mu me këto bindje kurrë mos u kthe hiq, se kam problem. Jakup, nëse do me debatu, ndalo debatojmë. Me diskutimet e Jakupit hiq nuk pajtohem. Remzia thotë, që paskam thanë fontan dëshirash. Unë kurrë nuk të kam ofendu edhe kjo konsideroj që prapë nuk është ofendim, vetëm për mu është fontan dëshirash. Nëse është një kërkesë e cila është e perealizuar, në rast se ti edhe grupi i juaj e kish marr buxhetin e kish shpërnda qe kaq në asfalt, kaq në ujë, kaq aty etj, qeto lokalitete mu me kish bind, por nëse ti vjen me 23 kërkesa vitin e kaluar e tash i paske reduktu në 10 dhe ato kërkesa kapin shumë ndoshta 4 milion, edhe unë i kam 2 milion, nuk është fontan dëshirash, të kam thanë edhe po të thamë, kur të fiton kandidati yt për kryetar komune, ta realizon programin tanë, përderisa është kryetar, ai që i ka fitu 12 mije vota, prioritet ka programi i kryetarit. Nëse ka vend për buxhet, hynë edhe kërkesat e juaja.

**z.Jakup Demiri:** Nënkyetar, prej 23 rekomandimeve të vitit të kaluar, pjesa më e madhe e tyre ato që kanë pas kosto janë kanë të llogaritura, nuk janë kanë fontan dëshirash, janë kanë të llogaritura. Ta përmenda ujin Letnica, që ka qenë prej 70 mijë deri 100 mije euro, që ka qenë me investu aty. Na e dimë qysh votohet buxheti, unë pata dëshirë me i shti këto rekomandime, ama po shifet që ju nuk keni vullnet.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar:** Jakup, bënu shumë fer, nëse e ki një program të komunës katër vjeçar dhe i ki kërkesat e opozitës, nesër ti e fiton pushtetin. Po ta marr shembull, cilat shkojnë sefte, banu parimor, se edhe kryetari i ka premtimet ndaj qytetarëve.

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Krejt ju të pranishmit e dini, që do sene edhe zogjtë e malit i dinë. Pse po e thamë këtë e dini ju. Dëshira ime është që mos me i personalizua gjërat këtu. Unë po e shoh që janë tu marr kahje senet që me i personalizua senet. Ne jemi krejt në shërbim të qytetarëve. Normal nënkryetar, që pos nevojës që është e domosdoshme, është edhe dëshirë e imja me i fornizu qytetarët me gjëra elementare, pa të cilat nuk munden me jetu. Ju kemi kërku edhe vitet e kaluar unë e Mirlinda, edhe pse nuk jemi kanë me një subjekt. Specifikoni gjërat, ta dimë se çka jemi tu bë. Qaj pak buxhet ke sa ke, po ta dimi se ku është tu shku. Ne nuk po e dimi edhe qaj pak buxhet se ka po shkon. Fundi i fundit, hiq ma larg se dje na tha hajde ulmi e bashkëpunojmë e gjejmë një zgjidhje, ku është në interes të qytetarëve. Ne sot e ofruam këtë, po ju nuk po doni me marr, atëherë çka me ju bë, unë nuk e di qysh po doni zgjidhje tjetër.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi nuk ka të tjerë për diskutim, unë e qes ne votim për miratim. Ju lutem me ngritje dore. Konstatoj që me 15 vota pro kalon kjo pikë e rendit të ditës.



**Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:**

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik**

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Të nderuar këshilltar, e keni para juve propozim vendimin, është fjala për dy lokacione, një në shtëpinë e kulturës dhe një në komunën e re, të cilën po mendoj që për shkak të kryerjes së shërbimeve të qytetarëve, që është tatimi në pronë, pagesat në ofiqari etj etj, që t'i kenë shërbimet aty afër dhe përmes ankandit ta ndajmë një pjesë të cilën do të konkurrojnë operatorët e ta marrin që qytetaret mos të maltretohen prej atjeshit me ardh në qendër, ndërsa tek shtëpia e kulturës, është fjala për at kafen të cilën e ka pas një operator që 10 vite, i ka skadu kontrata dhe tani ne kemi parapa që ta qesim serish përmes ankandit publik dhe t'i japin ofertust me të favorshëm për komunën.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmi u miratu kjo pik e rendit të ditës.

**Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:**

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme të komunës në shfrytëzim.**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Tek ky propozim vendim është bërë një gabim teknik. të cilin e tha dje nënkryetari. Bëhet fjalë për dy drejtor, që kanë qenë Nexhmedin Jakupi dhe Basri Aliu. Këta ndryshohen me dy të tjerë që janë propozu nga ekzekutivi, dhe hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Ali Bajrami:** Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, statutin e komunës, e kemi këtë propozim vendim, që në emër të grupit parlamentar të LDK-së e mbështesim dhe e përkrahim dhe në emër të grupit ne për anëtar të komisioni e propozojmë z.Ramadan Deliu.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Une e propozoj z.Vehbi Rama, pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u mirat edhe kjo pik e rendit të ditës.

**Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:**

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale afatshkurtër NPSH "Arena"**

**Drejtori z.Hasan Aliu nënkryetar:** Me lejoni t'i përshëndes këshilltarët të cilët ju bashkëngjiten punimeve të seancës, edhe kjo pikë është dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, por megjithatë është përmes procedurës së negociimit të cilën e mundëson edhe ligji, prandaj ju propozim e keni me të dhënat përkatëse.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe pika e pestë e rendit të ditës.

**Si pikë të gjatë të rendit të ditës kemi:**

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim plotësimit të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

**z.Hasan Aliu nënkryetar:** Po i propozoj te dy propozim vendime, sepse janë të natyrës së njëjtë. Vetëm personat ndryshojnë. Është fjala KKSJ-ja, bazë udhëzimit administrativ, e merr bekimin nga ana e kuvendit komunal. Prandaj, i kemi dy pozicione të cilët kanë lëvizë, është fjala për drejtoreshën e Arsimit, e cila ka shku në pozicion të ri dhe drejtorin që ka ardh, që sipas detyrës zyrtare është edhe anëtar i KKSJ-së, dhe e kemi pas nga shoqëria civile një anëtar, që ka shku për pune në Francë, që e kemi propozu një anëtar tjetër nga shoqëria civile.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këto dy pika. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmi u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

**Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:**

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim plotësimit të vendimit Nr.01-410/03-381, të datës 30.04.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këto dy pika. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

**Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:**

**8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2021**

Ne në vazhdimësi po thuaja që shtat vite kemi miratu gjithëherë nga një plan të punës. Ne kemi sjell propozim vendimi para juve, që të themelojmë grupin punës, në mënyrë që të miratojmë. Me miratimin e buxhetit edhe planin e punës së Kuvendit Komunal, unë kërkoj nga ju që t'i propozoni anëtarët e këtij grupi punuese. Nga LDK-ja Xhilsime Qamili, nga LVV- mungojnë, PDK-ja Avdi Rexhepi, nga AAK-ja Valentina Hasani, nga sekretaria e kuvendit, Fatlum Demiri dhe një nga shoqëria civile. Nëse nuk keni propozime tjera, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pik e rendit të ditës.

**Si pike të nëntë të rendit të ditës kemi:**

**9. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë, nga Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.**

**z.Nexhmedin Jakupi drejtor:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe Komuna e jonë si e gjithë Kosova ballafaqohet me një prej sfidave kryesore në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, e ajo është menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave. Edhe pse ka një përmirësim të theksuar të bazës ligjore dhe programore për sektorin e mbeturinave, mbetet angazhim dhe punë e vazhdueshme për përmirësimin e gjendjes aktuale. Për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në Komunën tonë, nevojitet një bashkëpunim më efikas dhe i qëndrueshëm i institucioneve dhe organizatave përgjegjëse, duke filluar nga kompania menaxhuese “Eco-Higjiena”, Inspeksioni, Policia, DKA, shoqëria civile dhe mjetet e informimit. Është koha e fundit që ne të ndryshojmë edhe perceptimin dhe qasjen që e kemi si shoqëri për mbeturinat. Komuna e jonë gjendet në fazën e parë të trajtimit të mbeturinave, pra merret vetëm me grumbullimin e mbeturinave. Bazuar në Ligjin mbi Mbeturinat 2011/04L 060, i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve të tjera të mbeturinave. Ky ligj përmes nenit 15 përcakton kompetencat e Komunës sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komuna është përgjegjëse sipas këtij neni (15) të hartoj dhe zbattoj Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjen e operatorëve të licencuar, si dhe përcaktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve. Komuna e jonë i ka të përmbushura këto obligime ligjore: Ka të krijuar një sistem për MM, ka planin lokal për menaxhim të mbeturinave që nga viti 2012, e të cilin në bashkëpunim me GIZIN- gjerman, këtë vit është ka e rishikon dhe modifikon PMM, si dhe ka punuar edhe në hartimin e rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave, është e përzgjedhur kompania për MM dhe Komuna ka caktuar tarifën e mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit. Në Komunën e Vitisë me menaxhimin e mbeturinave merret kompania “Eco-Higjiena”, SHPK-Gjilan-njësia në Viti, e cila është kompani private-publike e themeluar nga ndërmarrja publike KRM “Higjiena” SHA dhe MOSER GROUP dhe Ecovision SHPK. Komuna e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës kanë 49% të aksioneve, ndërsa Ecovisioni SHPK 51% të aksioneve në kompaninë “Eco-Higjiena”. Kjo marrëveshje është arritur më 24.05.2012 mes partnerëve të ardhshëm pas nënshkrimit të kontratës PPP, për një bashkëpunim 15 vjeçar. Kompania “Eco-Higjiena”- njësi në Viti, operon në 30 vendbanime të Komunës sonë, duke filluar nga Qyteti I Vitisë, Beguncë, Drobesh, Gërmovë, Goshicë, Kabash, Ramnishtë, Remnikë, Skifteraj, Pozhoran, Sllatinë e Poshtme, Sllatinë e Epërme, Stubëll e Epërme, Lubishtë, Budrikë, Fshati I Ri, Radivojcë, Ramjan, Sodovinë e Jerlive, Sodovine e M, Vërban, Tërstenikë, Tërpezë, Smirë, Zhiti, Ballancë, Potgorcë, Devaj, Binçë, dhe Qifllak. Pra, në sistem të menaxhimit të mbeturinave nuk janë fshatrat: Shushët, Debelldehu, Letnica, dhe Samakova, vendbanime të cilat kanë një numër të vogël të banorëve. Përcaktimi i shkallës së mbulimit me shërbim të grumbullimit të mbeturinave

është një detyrë mjaftë komplekse për shkak të dhënave kontradiktore, sa I përket popullatës që graviton në territorin administrativ të Komunës. Komuna edhe pse formalisht përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve nuk ka të dhëna vetanake se sa familje realisht gjenerojnë mbeturina dhe sa prej tyre pranojnë shërbime. Nga ana tjetër, kompania ka të dhëna se sa familje pranojnë shërbime nga databaza e faturimit nga “Eco-Higjiena”. Ky regjistër ka të meta, me që i njëjti nuk azhurnohet si duhet. Materialin e keni marr me kohe, për pyetje shtesë jam në dispozicioni e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ne tashti erdhëm për me e vazhdu pjesën e seancës. Pse na ishmi kundër vetëm ndaj asaj pike, ndërsa për neve tash është ne rregull seanca normale vazhdon. Tek pjesa e informatës së drejtorit në tabelë, ku shifet që ne bazë të numrit të familjeve ose ekonomive familjare dhe bizneseve që ekzistojnë dhe numrit i atyre që janë nënmenaxhim të mbeturinave dhe këtë nëse e analizojmë, është një gjendje jo e mirë jashtëzakonisht jo e mirë, sepse nuk e di sa janë reale këto vlera, nuk mu dokën reale, se komplet me ekonomi familjare, me biznese janë të regjistruara, kështu që e keni paraqit ju 8982, ndërsa prej 8982, 3704 janë nënmenaxhim të mbeturinave. D.m.th i bien pak mbi 30 % që janë nënmenaxhim të mbeturinave, e nëse është vetëm kjo, atëherë është një gjendje e ran. Unë konstatoj që është një gjendje jo e mirë në Komunën e Vitisë, sepse menaxhim të mbeturinave, d.m.th pjesa më e madhe e ekonomive familjare nuk ka, mirëpo tek kjo shifër që është, sa do të jete reale, tu e ditë që numri i banorëve rezident është dikun 50 mijë në Komunën e Vitisë dhe nga 8982 që janë të regjistruar duke i jek 1738 biznese që i ke paraqit këtu, atëherë na mbesin dikune pak mbi 7 mijë. Unë nuk mendoj që janë vetëm 7 mije ekonomi familjare, këtu mendoj që ka me shume se me 50 mije banor, na bien një familje mesatare mbi 7 anëtar me një familje që nuk mendoj që janë krejt të regjistruar këtu, pa i përfshi edhe ata që janë jorezidenc. Nuk e di sa është e saktë kjo tabelë, që unë mendoj që në menaxhim duhet të jetë çdo familje, çdo shpi të ketë menaxhim, që nëse dojmë me pas na një menaxhim të mirë një ambient të mire, mirëpo duhet të jete edhe një kompani që gjithmonë me pas një kapacitet që me e përballu dhe ana tjetër çka e pash, që është me shqetësuese, 1738 biznes që i ke paraqit këtu, vetëm 304 mu kanë në menaxhim të mbeturinave. Unë mendoj që është një padrejtësi shumë e madhe që behet tek bizneset, sepse 304 i ki shti në menaxhim, ndërsa të tjerat nuk kanë obligim ndaj kompanisë dhe nuk janë nën menaxhim. Unë mendoj që duhet të keni kujdes edhe plani që është duke u bërë, duhet të jete me e kompletme dhe ai plan dhe të jetë më i mirë shërbimi ndaj menaxhimit të mbeturinave që ti futmi krejt nën menaxhim të mbeturinave. Nëse i shtim krejt nën menaxhim të mbeturinave, edhe me shku çmimi me i vogël tek menaxhimi i mbeturinave, ki të hyra më të mëdhaja që kanë mundësi me funksionu kompania më mirë, sepse rriten të hyrat vetëm me e rrit numrin me i shti nën menaxhim dhe me e ulë çmimin, në bazë të dhënave që i kemi këtu unë u bazova.

**z.Zekirja Zuka:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Duke e falenderu drejtorin e Shërbimeve Publike për këtë informatë dhe për punën që po e kryen, e sidomos për mbeturinat, unë kam një kërkesë që edhe me herët e kam bërë pronaret e firmave ndërtime, me kërkuan e sidomos ata të merremtimeve, pra fasaderet kërkojnë nga ky ekzekutiv, që të ju sigurohet një deponi ku muj t’i grumbullojnë mjetet industriale, p.sh.: ngjyrat, thastë, mbetjet e llamarinave etj, në mënyrë që mos t’i hudhim në rrugë, sepse na e dimë që ata nuk kanë ku i hudhin. P.sh.: në Smirë para një jave njeri një kamjan e pruni e qiti dhe nuk patëm se çka me i bërë. Për të gjitha këto që ata i qesin, janë në gjendje me i pagu.

**z.Taulant Haxhiu:** Të nderuar të pranishëm! Edhe unë kam një pyetje për drejtorin. Në qendër të Vitisë edhe njëherë e kame paraqit si shqetësim të qytetarëve në qendër të Vitisë, tek rruga “Adem Jashari”, mbrapa ndërtesave, beso që u në aty apet si me shku fallugja. Ki shiringa, ke mbeturina, disa qytetar që mu më njofin dhe kanë raporte të mira më mu, gjithherë mu ankohen që mbrapa banesave të tyre është tmerr. Ki mbeturina të mëdhaja, shiringa, aty ka fëmijë të vogël, është mirë, ti i ki disa punëtor që ata po merren, është mirë që me i qu aty me i pastru ato mbeturina. Dëshiroj që të merr masa sa më shpejt që të pastrohen ato.

**z.Nexhmedin Jakupi drejtor:** Të nderuar këshilltar! Ju faleminderit për pyetjet. Kjo tabelë i referohet bazuar në të dhënat që i disponon kompania “Eko-Hixhena”, bazë databazes së tyre, se sa kujt i shërben dhe numrin e klientëve, ndërsa këtë numri, tjetër jemi bazu në statistikat në regjistrimin e popullatës dhe kemi bërë këtë tabelë,

mirëpo është e vërtetë që kompania nuk ka mbi 4000 klient dhe tani nëse e keni për bazë regjistrin e zyrës së tatimit në prone, e marr pasi që këshilltari i nderuar është nga Smira, ku figuron që numri i ekonomive familjare është 757, ndërsa kompania i ofron shërbime që ju merr mbeturinave në Smirë. Është dikun, 208 kjo është gjendje reale. Unë prandaj edhe kërkova dhe apelova, se këtu nuk mundet me zgjedh vetëm komuna apo Drejtoria e Shërbimeve Publike, kërkohet edhe nga inspektorati me udhëzimi e 2016, edhe policia ka të drejtë me e gjobit qytetarin kur sheh që hedh mbeturina vend e pa vend, prandaj kjo është sfidë për gjithë neve në Komunë, të gjithë qytetarët e komunës. Është interes i të gjithëve, na duhet gjithë mu mobilizu, nuk mundet vetëm një segment i shoqërisë me e zgjedh këtë problem, prandaj kërkova edhe prej mjeteve të informimi me e sensibilizu këtë. Ne jemi tu punu në rregullore dhe në plan, ku ne rregullore parashihet që kompania për momentin bën inkasimin, javë dërgon faturat çdo amvisrie desh i hedhi mbeturinat, desh i djegi, ai ka me pagu për mbeturina. Sa i përket pyetjes dhe një kërkesë e ka pas Taulanit, që ju të angazhoni më shume tek ata qytetar aty dhe ata t'i paguajnë mbeturinat, që mos t'i hedhin aty në ambient, se ata tjerët që jetojnë aty, i krijojnë mbeturinat, nuk shkon prej lagjes tjetër tek ajo lagje. Prandaj është mirë ju mu angazhu, me marr regjistrin, me punu me qytetar e përgjegjësia jonë është, nëse ne kompaninë nuk e qojmë aty me ju shërby.

**z.Bekim Azizi:** Unë mendoj që tash po thu 700 shtëpi e 208 në menaxhim. Kjo është një gjendje jo e mirë që e ka pas edhe kompania, një kompetencë që për menaxhim me të letë e ka marr vetëm një rrugë kryesore edhe ai qytetari që është në periferi atje edhe ai sa do lehtë shkon me pagu atje, kur nuk shkon me ja kry shërbimin, kompania ka shti shumë fshatra sa me pas regjistër, po i ka shti vetëm rrugët kryesore, ata çka janë jashtë rrugëve kryesore, familjet që janë në periferi, ata nuk kanë menaxhim të mbeturinave. Na duhet të mendojmë në të ardhmen ose ta bëjmë edhe një kompani të ja ndajmë territorin, nëse nuk e përballon vet, nëse hinë një fshat nën menaxhim të mbeturinave, duhet më hi çdo familje, çdo shtëpi. Nuk duhet me ja dhanë krejt fshatrat ki kapacitet për 10 fshatra, kapi komplet ato fshatra mos i ndaj qytetarët sikur ai në qendër sikur ai në periferi, kur janë në menaxhimin e mbeturinave. Ai që nuk ka menaxhim, nuk ka qare ato mbeturina pa i marr, pa i hedh dikun familjari, nuk mundet me i marr mbeturinat me shku me i hedh në deponi në Gjilan, nuk kemi na deponi legale që është nëpër fshatra, që mundet me shku me qit dhe ai çka ka me bë ka me dal në mënyrë të kundërligjshme me dal mi hudh me një vend që nuk shifen. Kjo është që një pjesë të madhe të fajit e kemi na që nuk kemi caktu vend, nuk kanë ku mi hedh mbeturinat, nuk i kemi shti nën menaxhim të mbeturinave. Për këtë arsye unë po diskutoj, që nën menaxhim qajo kompani që e merr, që e ka përgjegjësi, duhet me ditë kapacitetin e vet dhe me qat që e merr me e marr 100%, me e shti nën menaxhim të mbeturinave. Atëherë tani edhe ti si inspeksion ki mundësi me i gjobit, po kur nuk e shti nën menaxhim të mbeturinave, sun e gjobit ata, se ai dikun duhet me i hedh mbeturinat.

**z.Taulant Haxhiu:** Drejtor, po edhe unë pajtohem me ty që duhet së bashku ta ruajmë ambientin, po aty mbrapa banesave ku unë e përmenda, aty ka edhe shumë fëmij edhe fëmija nuk mundet me rujt dhe nuk është i pjekur që ta ruan ambientin. Ka erëra, unë edhe njëherë po të lus që desh me mu së bashku shkojmë edhe e shohim problematiken që është në qendër të Vitisë. Ka shumë banor dhe ish kanë mirë që sa më shpejt me marr hapa edhe me pastru ata tash. Çdo njeri krijon ndoshta bërlllok, po është mirë për qytetarët tonë me u kujdes edhe unë edhe ti aty ka edhe shiringa e tash shiringat nuk besoj që munden me i hek ata edhe unë e kame për me i rujtë feminë që jetojnë në ato ndërtesa.

**z.Nexhmedin Jakupi drejtor:** Po do ta kemi rregulloren e re, do ta kemi edhe planin po nëse nuk angazhohemi ne si qytetar dhe si shoqëri për me e zgjedh këtë problem, dokumentet na i kemi, ligjet e mira, udhëzimet administrative, rregullore të mira, po nëse nuk i zbatojmë, aty duhet edhe qytetarët me u involvu dhe të gjithë strukturat edhe komunale edhe inspeksioni edhe qytetari i thjesht që ka përgjegjësi morale, që nëse e sheh që dikush po hedh mbeturina vend e pa vend, duhet me e lajmëru rastin. Bekim, tu e pa gjendjen se qysh jemi në fillim të vitit, Drejtoria e Shërbimeve Publike i ka propozu kryetarit që me e nxjerr një urdhëresë, ku urdhëresa numër 02, e datës 10.02.2020, me të cilën janë urdhëru të gjitha subjektet afariste të ndërmarrjes shërbyese si dhe të gjithë prodhuesit të tjerë të mbeturinave komunale, amvistrinë, t'i menaxhojnë mbeturinat e krijuara nga produktet e tyre, duke ja dorëzuar kompanisë së licencuar mbeturinat për trajtimin dhe deponimin e tyre. Në këtë urdhëresë obligohet edhe kompania që të ofroj shërbime çdo qytetari dhe kemi bisedu me kompaninë, nëse kompania nuk është në gjendje,

atëherë kemi mëndu edhe varianti tjetër, që me nda në llogu më o lan hapësir edhe sektorit privat a po kushe është i interesuar që ka kapacitete me ofru shërbime me të mira kemi bisedu edhe me kompaninë e cila është zotu, ka kerku edhe jemi në komunikim në bashkëpunim me këshillat e fshatrave i kemi kerku nga ta që të përgatisin një regjistër, ta sjellin tek kompania dhe kompania do të ju ofron shërbim çdo lagje dhe do të shkon kamioni çdo lagje, ku janë rrugica të ngushta që nuk mundet me deportu kamioni, atëherë do ti qoj kontejnerë 1.1 dhe do të bënë zgjidhje.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Ju falënderoj për kontributin që keni dhënë, mirupafshim në seancën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:00 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**

---